<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2024</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime      Kapitale
A.1	Fletëpalosje (2000 copë * 25 lekë/copë)	<b>50</b>			50	
A.2	Guidë mbi historikun e VDK(500 copë *200 lekë/copë)	<b>100</b>			100	
<b>Shuma</b>		<b>150</b>			<b>150</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime      Kapitale
A.1	Fletëpalosje (2000 copë * 25 lekë/copë)	<b>50</b>			50	
A.2	Guidë mbi historikun e VDK(500 copë *200 lekë/copë)	<b>100</b>			100	
<b>Shuma</b>		<b>150</b>			<b>150</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b>			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>			
15 Janar – 15 Mars 2023			Drejtoria Ekonomike e Kulturës			
15 Janar – 15 Mars 2024			Muzeu Historik, Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës			
15 Janar – 15 Mars 2025			Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			
			<b>Institucioni Likuidues:</b> Drejtoria Ekonomike e Kulturës			

Nr.6	P08220.Q1.O1.A6 Cikël takimesh dhe bisedash mbi historinë dhe të kaluarën e Shqipërisë dhe Shkodrës në veçanti.	<b>Funksioni 8</b> <b>Argëtim, Kultura dhe Feja</b>  <b>N/funksioni 082</b> <b>Shërbime kulturore</b>  <b>Lloji i programit 08220</b> <b>Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.</b>				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>						
<b>i. Situata</b>						
<p>Vite më parë «Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës», filloi për herë të parë organizimin e një cikli bisedash për ndërgjegjësimin e të rinjve nën fokusin e librave me tematikë mbi të kaluarën.</p> <p>Këtë vit, me të ftuar të zgjedhur, intelektualë nga jeta aktive e qytetit, pedagogë dhe studiues etj. do të jenë të ftuar për të promovuar dhe diskutuar mbi botimet e reja, njëkohësisht edhe për tema mbi historinë e Shqipërisë dhe të Shkodrës në veçanti.</p> <p>Pjesëmarrës në këto takime do të jenë të rinj, nxënës të shkollave të mesme të Bashkisë Shkodër dhe studentë të Universitetit «Luigj Gurakuqi». Cikli i bisedave rezultojnë si një aktivitet i rëndësishëm, sidomos për të rinjtë, të cilët janë target grupi më i rëndësishëm ndër vizitorët tonë. Kjo gjë bën që ata të kenë njohuri për ngjarje të sjella përmes studimeve dhe botimeve të ndryshme të historisë tonë.</p> <p>Promovimi përmban në vetvete vlera të rëndësishme për të rritur ndërgjegjen e të rinjve sidomos karshi të kaluarës dhe për t'i shtyrë ato të lexojnë sa më shumë</p>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Promovimi dhe rritja e aktivitetit në “Vendin e Dëshmisë dhe Kujtesës”;</li> <li>• Krijimi i një tradite e cila duhet të zhvillohet në vitet në vazhdim për aktivitete të kësaj natyre;</li> <li>• Ndërgjegjësimi dhe edukimi i të rinjve mbi të kaluarën dhe historinë e Shqipërisë.</li> </ul>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përzgjedhja e botimeve</li> <li>• Përzgjedhja e të ftuarve</li> <li>• Zhvillimi i aktivitetit;</li> <li>• Promovimi i aktivitetit;</li> <li>• Raportimi dhe monitorimi.</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Promovimi i Vendi të Dëshmisë dhe Kujtesës;</li> <li>• Njohja e të rinjve me dëshmitë dhe pasojat e sistemit diktatorial;</li> <li>• Propozime të reja nga këto takime për zgjerimin e kurrikulave arsimore me këtë tematikë;</li> <li>• Pasurimi i bibliotekës së Muzeut me libra të rinj, kështu krijohet një fond i veçantë me libra të dedikuara të kaluarës dhe historisë së Shqipërisë.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Shkollat 9-vjeçare Shkollat e mesme Drejtoria Arsimore Rajonale, Shkodër Të rinj, turistë, përfaqësues të shoqërisë civile, studentë, specialistë të fushës etj.				Bashkia Shkodër Muzeu historik “Oso Kuka” Biblioteka “Marin Barleti” Organizata të shoqërisë civile		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023</b>		Totali (mijë lekë)	<b>Nga kjo:</b>			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Honorare të ftuarve (6 persona* 10,000 lekë/person)	60			60	
A.2	Honorar Moderator (1 person*10,000lekë)	10			10	
<b>Shuma</b>		<b>70</b>			<b>70</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2024</b>		Totali (mijë lekë)	<b>Nga kjo:</b>			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Shpenzime për aktivitetin	70			70	
<b>Shuma</b>		<b>70</b>			<b>70</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		Totali (mijë lekë)	<b>Nga kjo:</b>			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Shpenzime për aktivitetin	70			70	
<b>Shuma</b>		<b>70</b>			<b>70</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b>			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>			



Janar– Dhjetor 2023 Janar– Dhjetor 2024 Janar – Dhjetor 2025	Drejtoria Ekonomike e Kulturës Muzeu Historik, Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit <b>Institucioni Likuidues:</b> Drejtoria Ekonomike e Kulturës
--	---



Nr.7	P08220.Q1.O2.A1 Zhvillimi dhe pasurimi i fondit të Bibliotekës	<b>Funksioni 8</b> <b>Argëtim, Kultura dhe Feja</b>  <b>N/funksioni 082</b> <b>Shërbime kulturore</b>  <b>Lloji i programit 08220</b> <b>Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.</b>
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>		
<b>i. Situata</b>		
<p>Për funksionimin normal Degës Ekonomike të Kulturës është i domosdoshëm parashikimi (në bazë të strukturës aktuale) i shpenzimeve për paga dhe sigurime.</p> <p>Dega Ekonomike e Kulturës ka në strukturë 4 sektorë që ushtrojnë funksionet në 5 ndërtesa, të cilat kërkojnë mirëmbajtje dhe pastrim të vazhdueshëm.</p> <p>Në veprimtarinë e përditshme të punojësve, nevojiten pajisje kancelarike, sipas profileve të secilit pozicion të punës. Mbarëvajtja e punës në këto institucione, kërkon edhe kushtet e nevojshme në ambientet e këtyre institucioneve.</p> <p>Ambjentet e sektorëve të Degës Ekonomike të Kulturës janë të pajisura me sisteme të mbrojtjes nga zjarri të përbëra kryesisht me bombola të fikseve të zjarrit. Duke qenë se institucionet tona frekuentohen nga një publik i gjerë, na lind detyrimi t'i paraprijmë çdo lloj pakujdesie që do të shkaktoje ndonjë shkëndijë zjarri në ambientet e institucioneve.</p> <p>Pajisja me fiksë zjarri e institucioneve të cilët posedojnë vepra arti është gjithashtu një detyrim ligjor, i cili përmbushet cdo vit, me rimbushjen e bombulave ekzistuese.</p> <p>Kujdesi për parandalimin e dëmtimeve të inventarit fizik dhe të koleksioneve të ndryshme nga një sërë faktorësh natyrorë është një objektivi i përhershëm i punës sonë. Çdo vit realizohet kontrata me shoqëri të sigurimit për siguracion të ndërtesës, si mundësi e minimizimit të humbjeve në rastet e fatkeqësive natyrore dhe zjarrit.</p> <p>Në aspektin e mirëmbajtjes së ambienteve: në vitet e shkuara kemi realizuar në mënyrë të pjesshme hidroizolimim e tarracës së Bibliotekës "Marin Barleti", lyerja e ambienteve të brendshme të korridoreve dhe një pjesë e sallave, si dhe rehabilitimi i sistemit elektrik. Në vitin e kaluar u realizua lyerja dhe rregullimi i mermerëve të fasadës së Bibliotekës, ndërtimi "Muzeut të Librit". Rehabilitimi i tavolinave ekspozuese me qëllim përshtatjen e tyre për ekspozimin e librave antikuare dhe rehabilitimin e parketit dhe të sistemit të ndriçimit në ambientet e mediatekës.</p> <p>Për vitin 2023 parashikojmë që të vazhdojë mirëmbajtja dhe zëvendësimi i vetratave dhe dritareve të cilat kanë një amortizim të tejkajshëm rreth 52 vite përdorimi. Shërbim riparime për shmangien e lagështisë në Fondin e Fëmijëve. Gjithashtu vendosja e Vazove të mëdha statike për Hyrjen e Bibliotekës. Punime mirëmbajtje në ambientet e tualeteve të cilat janë në përdorim të personelit dhe të lexuesve në bibliotekë.</p> <p>Gjithashtu Salla e madhe ekspozuese e Galerisë së Arteve, e cila shtrihet në një hapësirë mbi 200 m<sup>2</sup>, ndahet në 3 hapësira pak a shumë të barabarta, të cilat prej vitesh nuk disponojnë një sistem kondicionimi i cili jo vetëm që rregullon temperaturën e brendshme, por prej shumë kohësh ka kufizuar mbarëvajtjen cilësore të aktiviteteve në stinën e dimrit dhe të verës, ku temperaturat kanë luhajtje ekstreme. Kjo situatë është komentuar nga publiku dhe artistët si jashtë standarteve dhe ndikon në statusin e vetë galerisë.</p> <p>Për sa më sipër është i domosdoshëm instalimi i tre kondicionerëve me fuqi 18 BTU inverter, me aftësi mbuluese të sipërfaqes së lartpërmendur (e përpjestuar).</p> <p>Për të bërë sa më të aksesueshëm në mënyrë dixhitale fondet e librave që nuk mund të dalin nga biblioteka, në mënyrë që të bëhet ruajtja e arkivave dixhitale, u mundësua furnizimi me një skaner/ fotokopje në banakun e bibliotekës që do tu shërbejë lexuesve. Duke patur parasysh normën e lartë të amortizimit të pajisjeve TIK, këtë vit mendojmë se është i nevojshëm plotësimi me kompjutera të rinj për punonjësit e Bibliotekës.</p> <p>Kujdesi për mirëmbajtjen e faqeve web të Degës Ekonomike të Kulturës, është një tjetër detyrim që na lind duke iu referuar komunikimit online dhe promovimit të aktiviteteve/ produkteve të sektorëve tonë.</p>		
<b>ii. Synimi i projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbatimi i detyrimit ligjor, mbi zhvillimin dhe pasurimin e koleksioneve.</li> <li>• Pasurimi i fondeve kryesore me literaturë bashkëkohore.</li> <li>• Pasurimi i katalogut on- line.</li> <li>• Përmirësimi i kushteve përmes administrimit, trajtimit dhe ruajtjes së materialeve bibliotekare me synimin, që pas disa vitesh nga magazinat e librave, të kthehen pika shërbimi me fonde të hapura.</li> </ul>		
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shqyrtimi i gjendjes së fondeve. Plotësimi i statistikave vjetore të hyrjeve të reja.</li> <li>• Evidentimi i frekuentimit vjetor të fondeve dhe lloji i literaturës së lexuar.</li> <li>• Ndjekja periodike e literaturës së publikuar.</li> <li>• Ndarja e shumës së planifikuar sipas fondeve.</li> <li>• Konsultimi me lexuesit.</li> <li>• Konsultimi me programet shkollore të literaturës së planifikuar për lexime.</li> <li>• Përcaktimi i fondeve ku do të ndërhyhet.</li> <li>• Gjetja e përkohshme e hapësirave, ku do të zhvendosen librat.</li> <li>• Bërja e analizës financiare</li> </ul>		
<b>b) Rezultatet që prisni</b>		

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pasurimi i fondeve me literaturë bashkëkohore.</li> <li>• Zgjerimi i aktivitetit të bibliotekës.</li> <li>• Shtimi i lexuesve.</li> <li>• Rritja e shërbimit ndaj komunitetit që përfshijnë të gjitha kategoritë e moshave.</li> <li>• Rritja e prestigjit të bibliotekës në rang kombëtar.</li> <li>• Përmirësimi i vendosjes dhe i trajtimit të librave.</li> <li>• Zgjerimi i hapësirave në dispozicion të librit.</li> <li>• Përmirësimi i shërbimit ndaj lexuesve.</li> <li>• Përpjekje për realizimin e normave të IFLA- s</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Bibliotekarët Publiku qytetar			Bashkia Shkodër.			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferi me
<b>A.1</b>	Blerje periodiku/gazeta (shqip + i huaj)	<b>100</b>				100
<b>A.2</b>	Blerje librash	<b>900</b>				900
<b>A.3</b>	Rafte për Libra					
	<b>Shuma</b>	<b>1,000</b>				<b>1,000</b>
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2024</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferi me
<b>A.1</b>	Shpenzime totale	<b>1,000</b>				1,000
	<b>Shuma</b>	<b>1,000</b>				<b>1,000</b>
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferi me
<b>A.1</b>	Shpenzime totale	<b>1,000</b>				1,000
	<b>Shuma</b>	<b>1,000</b>				<b>1,000</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar– Dhjetor 2023 Janar– Dhjetor 2024 Janar– Dhjetor 2025		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria Ekonomike e Kulturës Muzeu Historik, Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit <b>Institucioni Likuidues:</b> Drejtoria Ekonomike e Kulturës				

Nr.8	P08220.Q1.O2.A2 <b>Administrimi dhe menaxhimi i Degës Ekonomike të Kulturës.</b>	<b>Funksioni 8</b> <b>Argëtim, Kultura dhe Feja</b>  <b>N/funksioni 082</b> <b>Shërbime kulturore</b>  <b>Lloji i programit 08220</b> <b>Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.</b>
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>		
<b>i. Situata</b>		
<p>Për funksionimin normal Degës Ekonomike të Kulturës është i domosdoshëm parashikimi (në bazë të strukturës aktuale) i shpenzimeve për paga dhe sigurime.</p> <p>Dega Ekonomike e Kulturës ka në strukturë 4 sektorë që ushtrojnë funksionet në 5 ndërtesa, të cilat kërkojnë mirëmbajtje dhe pastrim të vazhdueshëm.</p> <p>Në veprimtarinë e përditshme të punojësve, nevojiten pajisje kancelarike, sipas profileve të secilit pozicion të punës. Mbarëvajtja e punës në këto institucione, kërkon edhe kushtet e nevojshme në ambientet e këtyre institucioneve.</p> <p>Ambjentet e sektorëve të Degës Ekonomike të Kulturës janë të pajisura me sisteme të mbrojtjes nga zjarri të përbëra kryesisht me bombola të fikseve të zjarrit. Duke qenë se institucionet tona frekuentohen nga një publik i gjerë, na lind detyrimi t'i paraprijmë çdo lloj pakujdesie që do të shkaktoje ndonjë shkëndijë zjarri në ambientet e institucioneve.</p> <p>Pajisja me fikse zjarri e institucioneve të cilët posedojnë vepra arti është gjithashtu një detyrim ligjor, i cili përmbushet çdo vit, me rimbushjen e bombulave ekzistuese.</p> <p>Kujdesi për parandalimin e dëmtimeve të inventarit fizik dhe të koleksioneve të ndryshme nga një sërë faktorësh natyrorë është një objektivi i përhershëm i punës sonë. Çdo vit realizohet kontrata me shoqëri të sigurimit për siguracion të ndërtesës, si mundësi e minimizimit të humbjeve në rastet e fatkeqësive natyrore dhe zjarrit.</p> <p>Në aspektin e mirëmbajtjes së ambienteve: në vitet e shkuara kemi realizuar në mënyrë të pjesshme hidroizolimim e tarracës së Bibliotekës "Marin Barleti", lyerja e ambienteve të brendshme të korridoreve dhe një pjesë e sallave, si dhe rehabilitimi i sistemit elektrik. Në vitin e kaluar u realizua lyerja dhe rregullimi i mermerëve të fasadës së Bibliotekës, ndërtimi "Muzeut të Librit". Rehabilitimi i tavolinave ekspozuese me qëllim përshtatjen e tyre për ekspozimin e librave antikuare dhe rehabilitimin e parketit dhe të sistemit të ndriçimit në ambientet e mediatekës, si dhe te behet e mundshme mbeshtetja e organizimit të një panairi libri në Shkodër.</p> <p>Për vitin 2023 parashikojmë që të vazhdojë mirëmbajtja dhe zëvendësimi i vetratave dhe dritaret të cilat kanë një amortizim të tejskajshëm rreth 52 vite përdorimi. Shërbim riparime për shmangien e lagështisë në Fondin e Fëmijëve. Gjithashtu vendosja e Vazove të mëdha statike për Hyrjen e Bibliotekës. Punime mirëmbajtje në ambientet e tualeteve të cilat janë në përdorim të personelit dhe të lexuesve në bibliotekë.</p> <p>Gjithashtu Salla e madhe ekspozuese e Galerisë së Arteve, e cila shtrihet në një hapësirë mbi 200 m<sup>2</sup>, ndahet në 3 hapësira pak a shumë të barabarta, të cilat prej vitesh nuk disponojnë një sistem kondicionimi i cili jo vetëm që rregullon temperaturën e brendshme, por prej shumë kohësh ka kufizuar mbarëvajtjen cilësore të aktiviteteve në stinën e dimrit dhe të verës, ku temperaturat kanë luhajat ekstreme. Kjo situatë është komentuar nga publiku dhe artistët si jashtë standarteve dhe ndikon në statusin e vetë galerisë.</p> <p>Për sa më sipër është i domosdoshëm instalimi i tre kondicionerëve me fuqi 18 BTU inverter, me aftësi mbuluese të sipërfaqes së lartpërmendur (e përpjestuar).</p> <p>Për të bërë sa më të aksesueshëm në mënyrë dixhitale fondet e librave që nuk mund të dalin nga biblioteka, në mënyrë që të bëhet ruajtja e arkivave dixhitale, u mundësua furnizimi me një skaner/ fotokopje në banakun e bibliotekës që do të shërbejë lexuesve. Duke patur parasysh normën e lartë të amortizimit të pajisjeve TIK, këtë vit mendojmë se është i nevojshëm plotësimi me kompjutera të rinj për punonjësit e Bibliotekës.</p> <p>Kujdesi për mirëmbajtjen e faqeve web të Degës Ekonomike të Kulturës, është një tjetër detyrim që na lind duke iu referuar komunikimit online dhe promovimit të aktiviteteve/ produkteve të sektorëve tonë.</p>		
<b>ii. Synimi i projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>Të rritet cilësia e ofrimit të shërbimit në funksion të pasurimit të jetës artistike, kulturore, edukuese për komunitetin.</li> <li>Qasja ndaj përvojave bashkëkohore të lidhura me akumulimin, sistemimin, administrimin dhe vënien në përdorim të informacionit për përdoruesin, përmes hostimit dhe mirëmbajtjes së vazhdueshme të katalogimit elektronik □</li> <li>Rritja e sigurisë në institucionet e kulturës dhe e frekuentuesve të këtyre institucioneve.</li> <li>Normaliteti në ecurinë e punëve të përditshme, si dhe ruajtja e personelit dhe e përdoruesve të bibliotekës.</li> </ul>		
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>Përcaktimi i prioritetëve në mbarëvajtjen e punës.</li> <li>Përcaktimi i materialeve më të domosdoshme për të realizuar aktivitetet.</li> <li>Përcaktimi i i shpenzimeve për paga dhe sigurimet për punonjësit e Degës Ekonomike të Kulturës dhe shpenzimeve të tjera të nevojshme për institucionet e D.E.K.</li> </ul>		
<b>b) Rezultatet që prisni</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>Krijimi i mundësive të reja për qasje në rrjete të integruara ndërkombëtare.</li> <li>Normalitetit në përditshmërinë e aktivitetit të Institucioneve të Degës Ekonomike të Kulturës</li> <li>Rritja e sigurisë</li> </ul>		
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>	<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
Institucionet dhe punonjësit përkatës të DEK Publiku qytetar	Bashkia Shkodër.	
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023</b>	Totali	Nga kjo:



		(mijë lekë)	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Paga	<b>18,594</b>	18,594				
A.2	Sigurime Shoqërore	<b>3,030</b>		3,030			
A.3	Materiale pastrimi /sanitare	<b>60</b>			60		
A.4	Shërbim nga të tretë (Energji, ujë, postë)	<b>1,150</b>			1,150		
A.5	Shërbim security	<b>350</b>			350		
A.6	Dieta	<b>50</b>			50		
A.7	Shërbim Interneti dhe Telefonie	<b>140</b>			140		
A.8	Materiale Kancelarie	<b>150</b>			150		
A.9	<b>Materiale promovionale per organizimin e panairit te librit ne Shkoder.</b>	<b>50</b>			<b>50</b>		
A.10	Shpenzime mirëmbajtje ndërtesë Biblioteka	<b>650</b>			650		
A.11	Siguracion ndërtesë	<b>100</b>			100		
A.12	Rimbushje Fikse Zjarri	<b>100</b>			100		
A.13	WEB Hostim, Domein dhe Mirëmbajtje Serveri për 1 vit	<b>110</b>			110		
A.14	Shperblim per dalje ne pension	<b>136</b>				136	
	Blerje Kondicionere Galeria e Arteve Shkoder	<b>507</b>					507
	<b>Shuma</b>	<b>25,177</b>	<b>18,594</b>	<b>3,030</b>	<b>2,910</b>	<b>136</b>	<b>507</b>
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2024</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Paga	<b>18,594</b>	18,594				
A.2	Sigurime Shoqërore	<b>3,030</b>		3,030			
A.3	Shpenzime të ndryshme operative	<b>2,910</b>			<b>2,910</b>		
A.4	Blerje Kondicionere	<b>600</b>					600
	<b>Shuma</b>	<b>25,134</b>	<b>18,594</b>	<b>3,030</b>	<b>2,910</b>		<b>600</b>
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Paga	<b>18,594</b>	18,594				
A.2	Sigurime Shoqërore	<b>3,030</b>		3,030			
A.3	Shpenzime të ndryshme operative	<b>2,910</b>			<b>2,910</b>		
A.4	Blerje Kondicionere	<b>600</b>					600
	<b>Shuma</b>	<b>25,134</b>	<b>18,594</b>	<b>3,030</b>	<b>2,910</b>		<b>600</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë vitit 2023 Gjatë vitit 2024 Gjatë vitit 2025		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria Ekonomike e Kulturës Stafi i Bibilotekës "Marin Barleti" <b>Institucioni Likujdues:</b> Drejtoria Ekonomike e Kulturës					

Nr.9	P08220.Q1.O2.A3 Periodiku "Gegnia"	<b>Funksioni 8</b> <b>Argëtim, Kultura dhe Feja</b>  <b>N/funksioni 082</b> <b>Shërbime kulturore</b>  <b>Lloji i programit 08220</b> <b>Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore</b>				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>						
<b>i. Situata</b>						
<p>Gegnishtja është një nga dialektet kryesore, me një sistem morfolojik dhe sintaksor të zhvilluar ndër vite. Mjaft shkrimt të trevave të veriut kanë dhënë kontributin e tyre në lëvrimin e këtij dialekti. Dokumentat më të vjetër të gjuhës shqipe janë shkruar në gegnisht. Në këtë dialekt u krijuan veprat dhe kryeveprat e letërsisë shqiptare nga Fishta, Gjeçovi, Mjeda, Koliqi, Camaj, Draçini etj.</p> <p>Gjatë periudhës moniste qëllimshëm u mënjanua përdorimi i formave të gegnishtes në gjuhë dhe letërsi, gjë që me kalim e kohës solli edhe mospërdorimin e saktë të formave gjuhësore të dialektit.</p> <p>Ruajtja e këtij varianti të shqipes së shkruar përmes këtij projekti është në koherencë me misionin e madh të kulturës, atë të pasurimit dhe trashëgimit të vlerave kulturore, që rrezikojnë të humbasin.</p> <p>Periodiku do të përcjellë brezave të rinj thesarin gjuhësor që trashëguam, thesar i cili nuk njihet thuajse fare nga ata. Shkrimtarët dhe studiuesit do të sjellin edhe forma të reja të evolimit të dialektit geg në vite. Revista do të krijojë mundësi të shprehurit ndryshe në gjuhën dialektore shkrimtarëve, përdoruesve dhe hulumtuesve të gjuhës geqe. Numri i parë i revistës u publikua më 27 nëntor 2016.</p> <p>Botimi i revistës si pronë kulturore-artistike e bibliotekës së Shkodrës, institucion kulturor në varësi të Bashkisë Shkodër ngjallur një interes mjaft të madh jo vetëm në mjedisin qytetar shkodran, por edhe më gjerë.</p> <p>Botimi i kësaj reviste ka ringjallur pas shumë viteve, një traditë të vyer të Shkodrës, atë të shtimit dhe të ripërtëritjes të revistave kulturore të traditës duke synuar që ajo të jetë përkrah revistave të njohura shkodrane, si: "Agimi", "Cirka", "Fryma" e "Kritika" etj.</p> <p>Revista është një mundësi dhe një arsye më tepër për shkëmbimin e mendimit shkencor rreth çështjeve të ndryshme kulturore dhe shkencore të kohëve që jetojmë, gjithnjë duke respektuar tjetrin dhe arritjet e shkencës në përgjithësi.</p> <p>Revista përmban një larmi rubrikash, përmes të cilave synohet rritja e bashkëpunimit me qytetarët dhe studiuesit, si një mundësi e pasurimit të trajtesave të saja. Revista do të vijojë të financohet nga Bashkia Shkodër.</p> <p>Duke patur parasysh veprimtarinë që ka Biblioteka në promovimin e librave që lidhen me traditën gjuhësore dhe letrare, anëtar i redaksisë do të angazhohet edhe në përzgjedhjen dhe analizat e materialeve që do të paraqiten në aktivitet promovues si dhe mbështetjen e Shoqatës së Shkrimtarëve të Shkodrës.</p>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ruajtja, pasurimi dhe trashëgimia e vlerave kulturore që rrezikojnë të humbasin, mes të cilave edhe dialekti gegë.</li> <li>• Shkëmbimi i mendimit qytetar dhe të specializuar rreth çështjeve të ndryshme kulturore të kohës.</li> <li>• Krijimi i një organi letrar të lirë dhe të panënçmuar të shkrimtarëve (shkodranë dhe jo shkodranë), që dëshirojnë të shkruajnë dhe të shprehin në gegnisht.</li> <li>• Evidentimi dhe publikimi i vlerave të ndryshme kulturore të papublikuara.</li> <li>• Ripërtëritja e një tradite të hershme të ambientit kulturor të qytetit, atë të periodikëve të ndryshëm.</li> <li>• Sigurimi i vazhdimësinë së revistës në vite.</li> </ul>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ngritja e redaksisë. Përcaktimi i platformës redaksionale.</li> <li>• Caktimi i periodicitetit (revistë e përvitshme, gjashtëmujore, në dy numra).</li> <li>• Përcaktimi i formave gramatikore të të shkruarit në gegërisht.</li> <li>• Evidentimi autorëve që lëvrojnë me botimet dhe origjinalitetin e shkrimeve.</li> <li>• Zyrtarizimi i revistës. Plotësimi i dokumentacionit për marrjen e ISSN</li> <li>• Paraqitja dhe publiciteti i numrave të rinj.</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Qytetit do t'i shtohet numra të rinj të revistës.</li> <li>• Bibliotekës do t'i shtohet një pronë letrare.</li> <li>• Rivitalizimi i autorëve të vjetër të shqipes.</li> <li>• Njohja e të rinjve me pasurinë gjuhësore dhe letrare të dialektit geg.</li> <li>• Rritja e krijimtarisë letrare të shkrimtarëve që lëvrojnë gegnishten.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Komuniteti i shkrimtarëve, gjuhëtarëve, studiuesve dhe i lexuesve që preferojnë gjuhën, leximin dhe përdorimin e gjuhës geqe.				Bashkia Shkodër.		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
A.1 Honorare për redaksinë (3 studiues; 1/redaktor/korrektor * 20,000			Paga	Sigurimi	Operative	Transferrime Kapitale



	lekë/për botim * 3 botime)	<b>240</b>			240		
A.2	Botime Gegnia (2 numra, 150-200 kopje/botim)	<b>160</b>			160		
A.2	Botime "Pena e Shkodrës" (1 numër, 150-200 kopje/botim)	<b>80</b>			80		
	Shuma	<b>480</b>			<b>480</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2024</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Siguri me	Opera tive	Transfe rime	Kapit ale
A.1	Shpenzime për aktivitetin	<b>480</b>			480		
	Shuma	<b>480</b>			<b>480</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Siguri me	Opera tive	Transfe rime	Kapit ale
A.1	Shpenzime për aktivitetin	<b>438</b>			438		
	Shuma	<b>438</b>			<b>438</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë vitit 2023 Gjatë vitit 2024 Gjatë vitit 2025		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria Ekonomike e Kulturës Stafi i Biblliotekës "Marin Barleti" <b>Institucioni Likuidues:</b> Drejtoria Ekonomike e Kulturës					

Nr.10	P08220.Q1.O2.A4 Festivali letrar i Shkodrës	Funksioni 8 Argëtim, Kultura dhe Feja  N/funksioni 082 Shërbime kulturore  Lloji i programit 08220 Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.										
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>												
<b>i. Situata</b>												
<p>Organizimi i veprimtarive kulturore është pjesë e pandarë e veprimtarive të bibliotekave, sidomos atyre publike, të cilat në ditët e sotme nuk janë thjesht vende të kërkimeve shkencore, por ata përpiqen të gjejnë forma dhe mënyra të reja për të ndikuar në jetën intelektuale, kulturore dhe shoqërore të njerëzve.</p> <p>Festivali letrar i Shkodrës është një aktivitet kulturor, që në bibliotekën tonë zhvillohet që prej dhjetë vitesh. Ai lindi me kërkesën e vetë shkrimtarëve shkodranë, që dëshironin të kishin një forum të përvitshëm letrar. Ky forum letrar i është dedikuar kryesisht shkrimtarëve shkodranë, që jetojnë në Shkodër dhe jashtë saj, por është synuar të jetë edhe një urë lidhëse me shkrimtarë të hapësirave shqiptare nga Diaspora.</p> <p>Ideja e krijimit të këtij aktiviteti ishte për të bërë të mundur kontaktin e drejtpërdrejtë të krijuesve me lexuesit dhe anëtarët e bibliotekës.</p> <p>Pjesëmarrësit e ftuar kanë paraqitur krijimtarinë e tyre dhe kanë referuar rreth temave të ndryshme, që lidhen me zhvillimet letrare bashkëkohore. Festivali nuk është shoqëruar me çmime. Në optikën e organizatorëve, çmimin, çdo shkrimtari ia jep lexuesi. Gjatë viteve janë paraqitur rreth 50 shkrimtarë. Festivali nuk ka arritur të plotësojë të gjitha kërkesat e autorëve. Ai zgjon interesimin e një publiku të gjerë, i cili nga viti në vit e ka mirëpritur dhe është rritur në numër. Është shtuar edhe interesimi i mediave lokale dhe kombëtare. Festivali ka ruajtur ritmikën kohore të zhvillimit. Qëllimi i kësaj nisme është të tërheqë shkrimtarët e rinj, kryesisht studentët.</p>												
<b>ii. Synimi i projektit</b>												
<p>Promovimi i vlerave krijuese të autorëve shkodranë, që banojnë në Shkodër dhe jashtë saj, përmes nxitjes së debatit letrar.</p> <p>Promovimi i shkrimtarëve të rinj</p> <p>Rritja e kulturës së të lexuarit të librit</p> <p>Rritja e shkëmbimeve ndërkulturore në hapësirat shqiptare.</p>												
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>												
<p>Organizimi i katër takimeve të forumit të letrarëve gjatë muajve tetor- nëntor</p> <p>Përcaktimi i pjesëmarrësve dhe kontakti me ata.</p> <p>Përcaktimi i tematikës së çdo takimi.</p> <p>Koordinim i veprimtarisë së Bibliotekës me shoqatat kulturore mbarëshqiptare për promovimin e arritjeve të letërsisë bashkëkohore në këto hapësira;</p>												
<b>b) Rezultatet që prisni</b>												
<p>Vijueshmëria e forumit letrar.</p> <p>Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në këtë aktivitet.</p> <p>Ngritja e nivelit të aktivitetit përmes pjesëmarrjes së një shkrimtari të shquar të vitit.</p> <p>Rritja e bashkëpunimeve ndërkulturore.</p> <p>Rritja e frekuentuesve të bibliotekës.</p> <p>Shtimi i kontakteve shkrimtar- lexues.</p>												
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>	<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>											
<p>Shkrimtarë</p> <p>Shoqata shkrimtarësh</p> <p>Shoqata rinore</p> <p>Shoqata kulturore nga Diaspora</p>	<p>Bashkia Shkodër.</p> <p>Biblioteka "Marin Barleti"</p>											
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>												
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023</b>	Totali (mijë lekë)	Nga kjo:										
A.1 Honorare për biseda letrare (5 shkrimtarë*10,000lekë/person)	50	<table border="1"> <tr> <td>Paga</td> <td>Sigurim e</td> <td>Operativ e</td> <td>Transferi me</td> <td>Kapitale</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>50</td> <td></td> <td></td> </tr> </table>	Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferi me	Kapitale			50		
Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferi me	Kapitale								
		50										
A.2 Honorare për moderator (4 takime * 5,000lekë/moderim)												
A.3 Akomodim për të ftuarit												
<b>Shuma</b>	<b>50</b>	<b>50</b>										
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2024</b>	Totali (mijë lekë)	Nga kjo:										
A.1 Shpenzime për zhvillimin e aktivitetit	50	<table border="1"> <tr> <td>Paga</td> <td>Sigurim e</td> <td>Operativ e</td> <td>Transferi me</td> <td>Kapitale</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>50</td> <td></td> <td></td> </tr> </table>	Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferi me	Kapitale			50		
Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferi me	Kapitale								
		50										
<b>Shuma</b>	<b>50</b>	<b>50</b>										
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>	Totali (mijë lekë)	Nga kjo:										
A.1 Shpenzime për zhvillimin e aktivitetit	50	<table border="1"> <tr> <td>Paga</td> <td>Sigurim e</td> <td>Operativ e</td> <td>Transferi me</td> <td>Kapitale</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>50</td> <td></td> <td></td> </tr> </table>	Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferi me	Kapitale			50		
Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferi me	Kapitale								
		50										



	<b>Shuma</b>	<b>50</b>		<b>50</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë vitit 2023 Gjatë vitit 2024 Gjatë vitit 2025	<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria Ekonomike e Kulturës Stafi i Biblotekës "Marin Barleti" <b>Institucioni Likuidues:</b> Drejtoria Ekonomike e Kulturës				



Nr.11	P08220.Q1.O2.A5: Të shkruajmë për të rinj	<b>Funksioni 8</b> <b>Argëtim, Kultura dhe Feja</b>  <b>N/funksioni 082</b> <b>Shërbime kulturore</b>  <b>Lloji i programit 08220</b> <b>Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.</b>				
<b>i. Situata</b>						
<p>Letërsia për fëmijë dhe të rinj është një ndërzharet më të veçanta të letërsisë. Vitet e fundit ajo është zbehur shumë dhe ka mungesë të theksuar të shkrimtarëve që e lëvrojnë këtë zhanër. Në qytetin e Shkodrës ka shumë të rinj dhe të reja të cilët lëvrojnë gjini të ndryshme të letërsisë.</p> <p>Në tetor të vitit 2021, u zhvillua aktiviteti i cili kishte në fokus njohuritë mbi Letërsinë për Fëmijë.</p> <p>Qëllimi i këtij propozimi është nxitja e të apasionuarve të letërsisë, të zhvillojnë njohuritë mbi Letërsinë për të Rinj.</p> <p>Aktiviteti do të zhvillohet në Bibliotekën «Marin Barleti», i ndarë në disa muaj, në formën e workshop-eve të ofruara falas për nxënës të shkollave të mesme dhe studentë të Universitetit «Luigj Gurakuqi», dega Letërsi. Aktiviteti do të realizohet në bashkëpunim me të gjitha shkollat e mesme të territorit të Bashkisë Shkodër dhe Universitetit «Luigj Gurakuqi».</p>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Evidentimi i të rinjve që lëvrojnë gjini të ndryshme të letërsisë;</li> <li>• Nxitja e të rinjve të lëvrojnë gjininë e Letërsisë për të rinj;</li> <li>• Promovimi i të rinjve që do të shfaqin talent për Letërsinë për të rinj ;</li> </ul>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxitja e bashkëpunimit me institucionet arsimore;</li> <li>• Kontakti me një shkrimtar me eksperiencë në fushën e Letërsisë për të rinj ;</li> <li>• Përgatitja e ambienteve për mbajtjen e orëve tëëorkshop-eve;</li> <li>• Promovimi i aktivitetit;</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritje e numrit të shkrimtarëve të letërsisë për të rinj;</li> <li>• Promovim i letërsisë për të rinj;</li> <li>• Nxitje e të rinjve për të ardhur në bibliotekë.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshmenëprojekt</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Stafi i Bibliotekës;</li> <li>• Ekspertë të letërsisë për të rinj;</li> <li>• Stafi i Drejtorisë së Kulturës</li> </ul>				Bashkia Shkodër Donatorë të mundshëm		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Honorar shkrimtari (1 * 3,000 lekë * 10 takime)	30			30	
<b>Shuma</b>		<b>30</b>			<b>30</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2024</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Zhvillim i aktivitetit	30			30	
<b>Shuma</b>		<b>30</b>			<b>30</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Zhvillim i aktivitetit	30			30	
<b>Shuma</b>		<b>30</b>			<b>30</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë vitit 2023 Gjatë vitit 2024 Gjatë vitit 2025			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria Ekonomike e Kulturës Biblioteka "Marin Barleti" Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit <b>Institucioni Likuidues: DEK</b>			

Nr.12	P8220.Q1.O3.A1 Administrimi dhe menaxhimi i Teatrit "Migjeni"	<b>Funksioni 8</b> <b>Argëtim, Kultura dhe Feja</b>  <b>N/funksioni 082</b> <b>Shërbime kulturore</b>  <b>Lloji i programit 08220</b> <b>Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.</b>				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>						
<b>i. Situata</b>						
<p>Institucioni i Teatrit "Migjeni" është një institucion varësie i Bashkisë Shkodër.</p> <p>Çdo aktivitet artistik që ndërmerret, është në bashkëpunim dhe me miratim të administratës së Bashkisë. Buxheti, niveli i pagave, nivelet e honorareve, etj. me propozimin e stafit të Teatrit miratohen nga Bashkia.</p> <p>Teatri "Migjeni" ka një strukturë prej 38 punonjës dhe artistë. Struktura përfshin drejtuesin, trupa artistike (që përfshin aktorë, instrumentistë, drejtues muzike dhe solistë) e përbërë nga 21 punonjës dhe shërbimet mbështetëse ku përfshihen (fonist, grimier, elektrikistë, punëtorë skene, punëtorë ndriçimi mixer, pastruese, piktor, marangoz, roje dhe arkivist) epërbërë nga 13 punonjës.</p> <p>Niveli i pagave është i bazuar në VKM Nr.1619, datë 2.7.2008, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore", i ndryshuar.</p> <p>Për funksionimin normal të saj është i domosdoshëm parashikimi (në bazë të strukturës aktuale) i shpenzimeve për paga dhe sigurime.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Në veprimtarinë e përditshme të institucionit dhe mbarëvajtjen e punës luajnë një rol shumë të madh shpenzimet operative siç janë materiale pastrimi/sanitare, shërbim nga të tretët (energji, ujë, telefon), materiale kancelarie, siguracion ndërtese, materiale të ndryshme mirëmbajtje si llampa, çelësa etj.</li> <li>Mirëmbajtje dhe pasurimi i garderobës. TEATRI MIGJENI disponon një garderobë të pasur që përdoret kryesisht për aktivitetet teatrore. Prandaj është e domosdoshme mirëmbajtja dhe pasurimi i saj.</li> <li>Shpenzime transporti. Udhëtimet brenda dhe jashtë vendit janë pjesë e pandashme për trupën teatrore të teatrit MIGJENI në kuadër të aktiviteteve të ndryshme artistike. Deri tani frupa artistike e TEATRIT MIGJENI është përfaqësuar me dinjitet duke fituar çmime të shumta.</li> <li>Printime dhe publikime. Shërbejnë për të pasuruar aktivitetin artistik dhe për t'i shërbyer artistëve dhe figurave të shquara të qytetit me publikime të ndryshme për jetën dhe veprën e tyre.</li> </ul>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>Të rritet cilësia e ofrimit të shërbimit në funksion të pasurimit të jetës artistike, kulturore edukuese për komunitetin.</li> <li>Rritja e sigurisë në institucionet e kulturës dhe e frekuentuesve të këtyre institucioneve.</li> <li>Normaliteti në ecurinë e punëve të përditshme.</li> <li>Promovimi i vlerave si një qytet me tradita kulturore dhe historike.</li> <li>Rritja e nivelit artistik në skenat më prestigjioze kombëtare dhe ndërkombëtare.</li> </ul>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>Përcaktimi i prioritetëve në mbarëvajtjen e punës.</li> <li>Përcaktimi i materialeve më të domosdoshme për të realizuar aktivitetet.</li> <li>Përcaktimi i shpenzimeve për Paga, Sigurime dhe shpenzime të tjera të nevojshme për institucionin.</li> <li>Vlerësimi i ftesave të ndryshme për pjesëmarrje në aktivitetet.</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>Evidentimi i vlerave artistike të grupeve në rang kombëtar dhe ndërkombëtar.</li> <li>Shkëmbimi i eksperiencave të ndërsjellta.</li> <li>Krijimi i mundësive të reja për qasje në rrjete të integruara lokale dhe ndërkombëtare.</li> <li>Normaliteti në përditshmërinë e aktivitetit të TEATRIT MIGJENI.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Trupa e Teatrit Migjeni. Publiku. Komuniteti artistik, instrumentistët dhe muzikantët.				Bashkia Shkodër.		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023</b>			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:		
A.1	Paga	24,351	Paga	24,153	Sigurime	198
A.2	Sigurime Shoqërore	3936		3,936		
A.3	Shërbim nga të tretët (internet, telefon)	100			100	
A.5	Shpenzime Transporti	200			200	
A.6	Materiale Kancelarie	20			20	
A.8	Materiale të ndryshme mirëmbajtje si llampa, çelësa etj	30			30	
A.9	Siguracion ndërtese	35			35	

A.10	Materiale pastrimi/sanitare	50			50		
A.11	Prodhim dhe shtypje biletash	150			150		
A.13	Shpenzime për pritje, përcjellje	200			200		
A.14	Siguracion ndërtese	50			50		
A.15	Udhëtimet brenda vendit	200			200		
A.16	Udhëtimet jashtë vendit	500			500		
A.17	Energji elektrike	758			758		
A.18	Ujë	630			630		
A.19	Telefon+ internet	80			80		
A.20	Lëndë djegëse	450			450		
A.21	Printime dhe publikime	500			500		
A.22	Furnizim me materiale higjiene	150			150		
A.23	Kancelari	200			200		
A.24	Blerje Kukulla Profesionale (18 kukulla )	180			180		
	<b>Shuma</b>	<b>32,770</b>	<b>24,153</b>	<b>3,936</b>	<b>4,483</b>	<b>198</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2024</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Paga	24,153	24,153				
A.2	Sigurime Shoqërore	3,936		3,936			
A.3	Shpenzime të ndryshme operative	4,483			4,483		
	<b>Shuma</b>	<b>32,572</b>	<b>24,153</b>	<b>3,936</b>	<b>4,483</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Paga	24,153	24,153				
A.2	Sigurime Shoqërore	3,936		3,936			
A.3	Shpenzime të ndryshme operative	4,483			4,483		
	<b>Shuma</b>	<b>32,572</b>	<b>24,153</b>	<b>3,936</b>	<b>4,483</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2023 Janar – Dhjetor 2024 Janar – Dhjetor 2025		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Teatri Migjeni Qendra Kulturore "Pjetër Gaci" <b>Institucioni Likujdues: Teatri "Migjeni"</b>					

<b>Nr. 13</b>	<b>P8220.Q1.O3.A2 Administrimi dhe Menaxhimi i Qendrës Kulturore Pjetër Gaci</b>	<b>Funksioni 8 Argëtim, Kultura dhe Feja</b>  <b>N/funksioni 082 Shërbime kulturore</b>  <b>Lloji i programit 08220 Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.</b>
---------------	--	--

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Qendra Kulturore "Pjetër Gaci" është institucion kulturor në varësi të Bashkisë Shkodër. Ky institucion është vazhdues i traditave më të mira kulturore- artistike të "Shtëpisë së Kulturës dhe Krijimtarisë Popullore" e themeluar në vitin 1945. Detyra kryesore e institucionit është ruajtja dhe evidentimi i vlerave më të mira të trashëgimisë kulturore-artistike të qytetit e më gjerë dhe transmetimi i tyre në mënyrë sa më dinjitoze pa lënë mënjanë vlerat e reja që krijohen. Gjithashtu, ky institucion, krijon lidhje me institucione të tjera të profilit, për zbatimin e politikave kulturore lokale dhe kombëtare. Bashkërendon punën me individë, shoqata apo institucione homologe në organizimin e aktiviteteve kulturore artistike.

- Qendra Kulturore "Pjetër Gaci" ka në strukturën e saj 4 punonjës dhe menaxhon trupa artistike që paguhen me honorare gjatë vitit siç janë: Orkestra Frymore, Grupi i Valleve. Gjithashtu menaxhon formacione më të vogla të krijuara nga artistë të ndryshëm në varësi të aktiviteteve.

Ajo merr pjesë në shumë aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, me ftesë të institucioneve serioze të artit dhe kulturës. Çdo vit këto ftesa trajtohen nga ekspertë të fushës, duke vlerësuar interesin e përfaqësimit. Pjesëmarrja në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, ndikon jo vetëm në shkëmbimin e eksperiencave mes artistëve dhe institucioneve të kulturës, por edhe në rritjen e nivelit artistik të grupeve tona artistike. Për funksionimin normal të saj është i domosdoshëm parashikimi (në bazë të strukturës aktuale) i shpenzimeve për paga dhe sigurime.

**ii. Synimi i projektit**

- Të rritet cilësia e ofrimit të shërbimit në funksion të pasurimit të jetës artistike, kulturore edukuese për komunitetin.
- Normaliteti në ecurinë e punëve të përditshme.
- Promovimi i grupeve artistike në rang kombëtar dhe më gjerë.
- Promovimi i vlerave si një qytet me tradita kulturore dhe historike.
- Rritja e nivelit artistik në skenat më prestigjioze kombëtare dhe ndërkombëtare.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Përcaktimi i shpenzimeve për Paga, Sigurime dhe shpenzime të tjera të nevojshme për institucionin.
- Realizimi i procedurave të nevojshme

**b) Rezultatet që prisni**

- Evidentimi i vlerave artistike të grupeve në rang kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Krijimi i mundësive të reja për qasje në rrjete të integruara lokale dhe ndërkombëtare.
- Normalitetin në përditshmërinë e aktivitetit të QKPG.

**c) Aktorët e mundshëm**

Qendra Kulturore "Pjetër Gaci".  
Publiku.  
Komuniteti artistik, instrumentistët dhe muzikantët.

**d) Kontributet e mundshme në projekt**

Bashkia Shkodër.

**e) Shpenzimet e llogaritura**

Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Paga	<b>2,690</b>	2,690				
A.2	Sigurime Shoqërore	<b>439</b>		439			
A.3	Materiale Kancelarie	<b>108</b>			108		
A.5	Shpenzime Transporti	<b>200</b>			200		
A.6	Materiale të ndryshme mirëmbajtje si llampa, celësa etj	<b>30</b>			30		
A.8	Materiale pastrimi/sanitare	<b>50</b>			50		
A.9	Siguracion ndërtese	<b>35</b>			35		
A.10	Energji elektrike	<b>250</b>			250		
A.17	Ujë	<b>100</b>			100		
A.18	Furnizim me materiale higjience	<b>50</b>			50		
A.13	Shpenzime për pritje, përcjellje	<b>200</b>			200		
A.14	Siguracion ndërtese	<b>50</b>			50		
A.15	Udhëtimet brenda vendit	<b>200</b>			200		



A.16	Udhëtimet jashtë vendit	<b>500</b>			500		
	<b>Shuma</b>	<b>4,902</b>	<b>2,690</b>	<b>439</b>	<b>1,773</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2024</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Paga e Sigurime Shoqërore	<b>3,129</b>	2,690	439			
A.2	Shpenzime operative	<b>1,773</b>			1,773		
	<b>Shuma</b>	<b>4,902</b>	<b>2,690</b>	<b>439</b>	<b>1,773</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Paga e Sigurime Shoqërore	<b>3,129</b>	2,690	439			
A.2	Shpenzime operative	<b>1,773</b>			1,773		
	<b>Shuma</b>	<b>4,902</b>	<b>2,690</b>	<b>439</b>	<b>1,773</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2023 Janar – Dhjetor 2024 Janar – Dhjetor 2025		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Qendra Kulturore "Pjetër Gaci" <b>Institucioni Likujdues:</b> Dega ekonomike e Kultures					





Nr.14	P08220.Q1.O3.A3 Orkestra Frymore- Honorare vjetore	Funksioni 8 Argëtim, Kultura dhe Feja							
		N/funksioni 082 Shërbime kulturore							
		Lloji i programit 08220 Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e							
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:									
i. Situata									
<p>Formacioni i Orkestrës Frymore është një nga vlerat e veçanta artistike unikale që ka qyteti ynë. Fillesat e saj datojnë në vitin 1876, e drejtuar fillimisht nga mjeshtri Giovanni Canale, për të vazhduar më pas me figura të shquara të artit shqiptar si Palok Kurti, Frano Ndoja, Sulë Liçaj, At Martin Gjoka, Luigj Prela, Abdulla Grimci, Zef Kurti, Prenkë Jakova, Nush Shllaku, Tonin Daija, Abdullah Salabegu dhe që nga viti 1986 e deri në vitin që shkoi nga Kujtim Alija, Mjeshtër i Madh.</p> <p>Siç dihet ky formacion është vijues i traditave më të mira të formacioneve që kanë debutuar në qytetin e Shkodrës dhe jo vetëm.</p> <p>E mbështetur nga Bashkia Shkodër dhe e menaxhuar nga Qendra Kulturore "Pjetër Gaci", është një formacion mjaft i konsoliduar.</p> <p>Ky formacion ka realizuar aktivitete të shumta, duke filluar nga koncerte- recitale, koncerte me rastin e festave kombëtare, parakalime në qytet, inagurime të ndryshme, përkujtime të figurave historike, pjesëmarrje në aktivitete koncertale dhe konkurruese brenda dhe jashtë vendit, ku si rezultat ka sjellë në Shkodër disa çmime kombëtare dhe Çmimin e parë në Festivalin e zhvilluar në Giulianova të Italisë.</p> <p>Prandaj ky formacion duhet të mbrohet dhe të mbështetet ashtu siç i takon edhe në vitet në vazhdim.</p> <p>Bashkia Shkodër çdo vit e ka financuar rregullisht për 11muaj të vitit, por edhe duke i siguruar realizimin e aktiviteteve të shumta.</p>									
ii. Synimi i projektit									
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ruajtja e traditës së këtij formacioni;</li> <li>• Realizimi i aktiviteteve me rastin e festave të ndryshme;</li> <li>• Gjallërimi i jetës artistike të qytetit;</li> <li>• Promovimi i vlerave artistike të kësaj trupe;</li> <li>• Nxitja e turizmit kulturor.</li> </ul>									
iii. Aktivitetet kryesore të projektit									
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Parashikimi në Projekt- Buxhet për financimin e Orkestrës Frymore;</li> <li>• Realizimi i kontratës kolektive me instrumentistët, palën dhe dirigjentin;</li> <li>• Realizimi i projekteve të ndryshme artistike për orkestrën dhe konkretizimi i tyre: <ul style="list-style-type: none"> <li>a) Karnavale- Parakalim në qytet.</li> <li>b) Festa e nënës- 8 Mars- Parakalim në qytet</li> <li>c) 2 prilli- Ceremonial zyrtar</li> <li>e) Dita e liqenit</li> <li>f) Korrik- performancë në kuadër të turizmit në njësinë administrative Velipojë (plazh)</li> <li>g) 9 Shtator- "Lëvizja e Postribës"- Ceremonial zyrtar;</li> <li>h) Shtator- Performancë në qytet, në kuadër të Javës së Trashëgimisë Kulturore;</li> <li>i) Tetor- Pjesëmarrje në festat e Njësive Administrative, të organizuara nga Bashkia Shkodër</li> <li>j) Mes tetori- Prova intensive për koncertin premierë;</li> <li>k) Nëntor "Java e Pavarësisë" Dita e Pavarësisë- Ceremonial Zyrtar;</li> <li>l) Koncert Premierë në Teatrin "Migjeni";</li> <li>m) Dhjetor (java e dytë)- Parakalime në qytet në kuadër të krijimit të atmosferës për festat e fundvitit.</li> </ul> </li> <li>• Rinovim dhe përzgjedhje e repertorit për të gjitha aktivitetet;</li> <li>• Sigurimi i partiturave;</li> <li>• Prova intensive me orkestrën;</li> <li>• Përgatitja e materialeve promociionale;</li> <li>• Promovimi në media i të gjithëaktiviteteve.</li> </ul>									
b) Rezultatet që prisni									
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Spektatorët marrin kënaqësinë e dëshiruar gjatë performancave artistike të Orkestrës Frymore.</li> <li>• Ruajtja e traditës së këtij formacioni, i cili njihet në arenën kombëtare e ndërkombëtare.</li> </ul>									
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt					
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Komuniteti artistik, instrumentistët dhe muzikantët, spektatorët e kualifikuar por dhe masa e gjerë.</li> </ul>				Bashkia Shkodër.					
e) Shpenzime të llogaritura									
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023				Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
					Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Honorar, Dirigjenti i orkestrës 1 person x 11 muaj x 22.000 lekë			242			242		



A.2	Honorar Instrumentist/ përgjegjës i trupës 1 person x 11 muaj x 12,000 lekë	132			132		
A.3	Honorare, Instrumentistë 38 persona x 11muaj x 11500 lekë	4,807			4,807		
	<b>Shuma</b>	<b>5,181</b>			<b>5,181</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2024</b>		Totali(mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpenzime për aktivitetin	5,181			5,181		
	<b>Shuma</b>	<b>5,181</b>			<b>5,181</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpenzime për aktivitetin	5,181			5,181		
	<b>Shuma</b>	<b>5,181</b>			<b>5,181</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2023 Janar – Dhjetor 2024 Janar – Dhjetor 2025		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Dega Ekonomike e Kultures. <b>Institucioni Likuidues:</b> Dega Ekonomike e Kultures					

Nr.15	P08220.Q1.O3.A4 Grupi orkestror i Qendrës Kulturore.	<b>Funksioni 8</b> <b>Argëtim, Kultura dhe Feja</b>  <b>N/funksioni 082</b> <b>Shërbime kulturore</b>  <b>Lloji i programit 08220</b> <b>Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.</b>																																																				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>																																																						
<b>i. Situata</b> Para 73 vjetësh, më 18 janar 1945, në qytetin e Shkodrës do të ngrihej shtëpia e parë e kulturës, që fillimisht u quajt "shtëpia e artit dhe e kulturës". Shkodra, qyteti që njihet për traditat e tij kulturore e artistike, për shoqëritë e shumta muzikore që vepronin këtu, tani do të kishte institucionin e parë kulturor. Ishte shumë shpejt, sapo ishte çliruar vendi dhe gjurmët e luftës ishin të pranishme. Intelektualët shkodranë, që më së shumti ishin diplomuar jashtë Shqipërisë, ishin nismëtarë të krijimit të këtij institucioni: Qemal Draçini, Filip Ndoçaj, Mark Ndoja, Ramadan Sokoli, Mikel Koliqi, Padër Gjon Shllaku, Myzafer Pipa, Vehbi Bala, Zef Kurti, Preng Jakova, Simon Rrota, Injac Zamputi etj. Ishin ato që më 6 janar u mbledhën dhe vendosën krijimin e grupit nismëtar për ngritjen e këtij institucioni. Kjo nismë kishte për qëllim vazhdimin e traditave të shquara kulturore e artistike të Shkodrës. "Do të ndërtojmë tempullin e kulturës shqiptare" shprehej Padër Gjon Shllaku, të cilin më pas e pushkatoi diktatura. Në këtë institucion funksiononin kurset për përgatitjen e këngëtarëve, valltarëve, instrumentistëve etj. dhe Jakova punonte për ngritjen e orkestrës simfonike. Në çdo festë a aktivitet kulturor, grupet e shtëpisë së kulturës ishin të pranishme, si dhe përfaqësojnë Shkodrën në aktivitete kombëtare duke marrë çmime të shumta. Në vitin 1951, orkestra e këtij institucioni merr statusin e gjysmë profesionistit. Aktualisht, ky institucion vazhdon të ekzistojë si Qendra kulturore "Pjetër Gaci". Ai është nën varësinë e Bashkisë Shkodër dhe pas vitit 1990. Sot Qendra Kulturore nuk ka akoma rolin dhe nuk ka siguruar vazhdimësinë e kësaj tradite pune. Për arsye të tranzicionit, nuk ka patur infrastrukturën mbështetëse në kohën kur ajo u transferua në pushtetin vendor, dhe një sërë faktorësh të tjerë që lidhen edhe me mënyrën e menaxhimit e artit në një sistem tjetër, sic është ai i tregut të lirë. Tashmë kjo qendër kulturore ka infrastrukturën, hapësirën e domosdoshme për zhvillimin e një aktiviteti më të gjerë, gjithëpërfshirës dhe njëkohësisht edhe aftësitë teknike menaxheriale dhe artistike për mbështetjen e aktiviteteve që kthejnë një traditë të punës me të rinjtë, amatorët, ata që janë të interesuar të kultivojnë artin dhe muzikën, lojën në instrument dhe këngën. Për këto arsye vitin që shkoi, e rindërtoam këtë eksperiencë përmes krijimit konkret të një grupi muzikor që trajnohet, edukohet dhe punon në funksion edhe të disa eventeve që bëhen në qytet. Hap pas hapi, kjo eksperiencë do të shërbejë si një bazë e mirë dhe e qëndrueshme për krijimin e një orkestre të mirëfilltë të qytetit të Shkodrës, një aset i munguar prej vitesh.																																																						
<b>ii. Synimi i projektit</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Vazhdimi i punës me një bërthamë orkestrorë me standarte europiane</li> <li>Angazhimi i kësaj bërthame orkestrorë në evente të ndryshme që zhvillohen në qytet</li> <li>Prurja e e tingëltimeve të kohës, atraktive e moderne përmes performimeve dhe arranjimeve cilësore.</li> <li>Mbështetja e të rinjve që studiojnë në shkollën e muzikës, që kanë ndjekur kurse në seksionet e muzikës në qendrën kulturore të fëmijëve, dhe të rinjve të qendrës rinore "Atelie"</li> </ul>																																																						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Përzgjedhja e elementëve që angazhohen</li> <li>Hartimi i planit të trajnimit dhe edukim</li> <li>Zhvillimi i seancave teknike të trajnimit dhe provat artistike</li> <li>Organizimi i aktiviteteve, performancë artistike në evente në qytetin e Shkodrës.</li> </ul>																																																						
<b>b) Rezultatet që prisni</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kthimi i traditës së punës të ish Shtëpisë së Kulturës në aktivitetin e qendrës kulturore "Pjetër Gaci"</li> <li>Zbulimi dhe mbështetja e talenteve të reja</li> <li>Gjithëpërfshirja e qytetarëve të Shkodrës në eventet artistike</li> </ul>																																																						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Shkolla e muzikës "Prengë Jakova"</li> <li>Qendra kulturore "Pjetër Gaci"</li> <li>Qendra rinore "Atelie"</li> </ul>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b> Bashkia Shkodër. Donatorë të mundshëm Ministria e Kulturës																																																		
<b>e) Shpenzime të llogaritura</b> <table border="1" data-bbox="248 1783 1401 2040"> <thead> <tr> <th colspan="2" data-bbox="248 1783 703 1843">Shpenzimet për çdo aktivitet 2023</th> <th data-bbox="703 1783 831 1843">Totali (mijë lekë)</th> <th colspan="5" data-bbox="831 1783 1401 1821">Nga kjo:</th> </tr> <tr> <th data-bbox="248 1821 304 1843"></th> <th data-bbox="304 1821 703 1843"></th> <th data-bbox="703 1821 831 1843"></th> <th data-bbox="831 1821 903 1843">Paqa</th> <th data-bbox="903 1821 1031 1843">Sigurime</th> <th data-bbox="1031 1821 1158 1843">Operative</th> <th data-bbox="1158 1821 1294 1843">Transferime</th> <th data-bbox="1294 1821 1401 1843">Kapitale</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="248 1843 304 1924">A.1</td> <td data-bbox="304 1843 703 1924">Honorar instrumentistë, këngëtar 1 person x 6 muaj x 10,000 lekë/muaj</td> <td data-bbox="703 1843 831 1924">600</td> <td data-bbox="831 1843 903 1924"></td> <td data-bbox="903 1843 1031 1924"></td> <td data-bbox="1031 1843 1158 1924">600</td> <td data-bbox="1158 1843 1294 1924"></td> <td data-bbox="1294 1843 1401 1924"></td> </tr> <tr> <td colspan="2" data-bbox="248 1924 703 1973"><b>Shuma</b></td> <td data-bbox="703 1924 831 1973"><b>600</b></td> <td data-bbox="831 1924 903 1973"></td> <td data-bbox="903 1924 1031 1973"></td> <td data-bbox="1031 1924 1158 1973"><b>600</b></td> <td data-bbox="1158 1924 1294 1973"></td> <td data-bbox="1294 1924 1401 1973"></td> </tr> <tr> <th colspan="2" data-bbox="248 1973 703 2040">Shpenzimet për çdo aktivitet 2024</th> <th data-bbox="703 1973 831 2040">Totali (mijë lekë)</th> <th colspan="5" data-bbox="831 1973 1401 2011">Nga kjo:</th> </tr> <tr> <th data-bbox="248 2011 304 2040"></th> <th data-bbox="304 2011 703 2040"></th> <th data-bbox="703 2011 831 2040"></th> <th data-bbox="831 2011 903 2040">Paqa</th> <th data-bbox="903 2011 1031 2040">Sigurime</th> <th data-bbox="1031 2011 1158 2040">Operative</th> <th data-bbox="1158 2011 1294 2040">Transferime</th> <th data-bbox="1294 2011 1401 2040">Kapitale</th> </tr> </tbody> </table>							Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:								Paqa	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale	A.1	Honorar instrumentistë, këngëtar 1 person x 6 muaj x 10,000 lekë/muaj	600			600			<b>Shuma</b>		<b>600</b>			<b>600</b>			Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:								Paqa	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:																																																			
			Paqa	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale																																															
A.1	Honorar instrumentistë, këngëtar 1 person x 6 muaj x 10,000 lekë/muaj	600			600																																																	
<b>Shuma</b>		<b>600</b>			<b>600</b>																																																	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:																																																			
			Paqa	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale																																															



A.1	Shpenzime për aktivitetin	600			600		
	<b>Shuma</b>	<b>600</b>			<b>600</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paqa	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpenzime për aktivitetin	600			600		
	<b>Shuma</b>	<b>600</b>			<b>600</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Maj – Tetor 2023 Maj – Tetor 2024 Mai – Tetor 2025		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i Qendrës Kulturore "Pjetër Gaci" <b>Institucioni Likuidues:</b> Dega Ekonomike e Kultures					



Nr.16	P08220.Q1.O3.A5 Çmimi "Pjetër Gaci"	<b>Funksioni 8</b> <b>Argëtim Kultura dhe Feja</b>  <b>N/funksioni 082</b> <b>Shërbime kulturore</b>  <b>Lloji i programit 08220</b> <b>Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.</b>						
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>								
<b>i. Situata</b>								
<p>Çmimi "Pjetër Gaci" është një takim interpretuesish në fushën e muzikës së kultivuar. Nga viti 2000 e në vazhdim, ky aktivitet organizohet çdo vit në qytetin e Shkodrës nga Bashkia Shkodër dhe Qendra Kulturore "Pjetër Gaci".</p> <p>Dimensionohet si një konkurs ndërkombëtar, i cili nga viti në vit është konsoliduar. Ai është i ndarë në kategori dhe degë të veçanta muzikore dhe pjesëmarrja është e lirë në bazë të kritereve të përcaktuara nga stafi organizativ, duke bashkëpunuar në mënyrë specifike me shkollat artistike.</p> <p>Aktiviteti zgjat katër ditë dhe regjistrimi në konkurs bëhet kundrejt një shifre financiare, të parashikuar në paketën fiskale të Bashkisë Shkodër.</p> <p>Juria e çdo kategorie përbëhet nga personalitete të muzikës klasike. Juritë mbledhen në finale për të dhënë Çmimin "Pjetër Gaci".</p> <p>Konkursi promovon talentet e reja në degë të ndryshme muzikore, duke ballafaquar njëkohësisht shkolla dhe stile të ndryshme interpretimi. Ai organizohet në qytetin tonë si një qytet me tradita në këtë fushë dhe mban emrin e "Pjetër Gacit", pasi ai përfaqëson atë brez muzikantësh të mirënjohur, të cilët na dhanë modele të krijimit dhe interpretimit muzikor, duke e transmetuar atë edhe në brezat e ardhshëm.</p> <p>Kompozitori shkodran Pjetër Gaci ishte violinist dhe pedagog i muzikës klasike. Rrugën e artit e filloi si violinist dhe u bë themeluesi i muzikës violinistike shqiptare. Arriti maja me kompozimin e këngës, si të "Për ty atdhe" dhe "Gryka e Kaçanikut". Pas vitit 1976 vendoset përfundimisht në Shkodër, ku krahas kompozimit u përkujdes edhe për klasën e violinës në shkollën e mesme artistike "P.Jakova" të këtij qyteti. Ai ka meritën të ketë kompozuar të parin koncert për violinë në historinë e muzikës shqiptare, të parën baladë për violinë dhe piano, si dhe të jetë anëtar i Trios së parë instrumentale (pranë TOB, 1956). Prija kryesore në krijimtarinë e tij do të mbetet muzika vokale, në të cilën ka lënë shembuj të paharruar veprash që nga kënga e deri tek opera, si opera "Toka jonë", "Përtej mjegullës", kantata "O moj Shqipni, e mjera Shqipni", "Për ty Atdhe".</p> <p>Pjetër Gaci, është një ndër artistët që ka frymëzuar një gjeneratë të tërë me një kontribut në zhanre të ndryshme si: Opera, Muzikë simfonike, Muzikë orkestrale, Koreografi, Muzikë vokale, Muzikë filmash, Këngë të Muzikës së Lehtë, Muzikë për fëmijë, Material Didaktik për Shkollat e Muzikës etj. Për fat të keq, shumë vepra, janë akoma të pabotuara, dhe të shpërndara në institucione dhe persona të ndryshëm.</p>								
<b>ii. Synimi i projektit</b>								
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjallërimi i jetës artistike të qytetit.</li> <li>• Evidentimi dhe promovimi i talenteve të reja në degë të ndryshme muzikore duke ballafaquar njëkohësisht shkolla dhe stile të ndryshme interpretimi.</li> <li>• Promovimi i vlerave si një qytet me tradita kulturore dhe historike në pjesëmarrësit e shumtë që vijnë nga qytete dhe vende të tjera.</li> </ul>								
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>								
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ngritja e grupit realizues.</li> <li>• Bashkëpunim me institucione dhe specialistë që përfaqësojnë shkollat artistike pjesëmarrëse.</li> <li>• Sigurimi i pjesëmarrjes, brenda dhe jashtë vendit.</li> <li>• Përzgjedhja e një jurie profesionale me personalitete shqiptarë dhe të huaj.</li> <li>• Sigurimi i infrastrukturës, hoteleri, restorante dhe ambiente ku do të mbahen audicionet.</li> <li>• Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve promociionale.</li> <li>• Realizimi i dekorit.</li> <li>• Bashkërendimi i punëve me zyrën ekonomike të Teatrit "Migjeni" për realizimin e aktivitetit.</li> </ul>								
<b>b) Rezultatet që prisni</b>								
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritje e interesit dhe e cilësisë së interpretimit të muzikës së kultivuar.</li> <li>• Edukimi i shijëve artistike të ardashësve në masë të gjerë.</li> <li>• Promovimi i talenteve të reja në fushën e muzikës së kultivuar.</li> <li>• Vlerësimi i figurës së Pjetër Gacit.</li> </ul>								
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshmenëprojekt</b>				
Artistët e rinj dhe artdashësit. Shkollat artistike Komuniteti artistik.				Bashkia Shkodër. Të ardhurat nga regjistrimet. Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër Teatri "Migjeni". Shoqata artistike Donatorë të mundshëm.				
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>								
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023</b>				Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Honorare, fituesit për çdo kategori, (i mesëm)			112			112	

	(8 interpretues x 14 lekë/person.)						
A.2	Honorare, fituesit për çdo disiplinë, (cikli i Iartë)(8 interpretues x 20 lekë/person.)	160		160			
A.3	Honorar, Çmimi Special (1 interpretues x 50 lekë/person).	50		50			
A.4	Honorare, Juria (nga vendi) (5 persona x 20,000 lekë)	100		100			
A.5	Honorare, Juria (personalitete jashtë vendit tonë) (7 persona x 35 lekë/person)	245		245			
A.6	Honorar, Drejtor artistik, (1 person x 50 lekë/person)	50		50			
A.7	Honorar, Konsulent artistik, (1 person x 25 lekë/person)	25		25			
A.8	Honorare, Shoqërues në piano, (4 persona x 15 lekë/person)	60		60			
A.9	Honorar, Regjizor, (1 person x 20 lekë/person).	20		20			
A.10	Honorar, Konferencier/Skenari, (1 person x 20 lekë/person)	20		20			
A.11	Honorar, Artist i/e ftuar, (1 person x 35 lekë/person)	35		35			
A.12	Trajtim ushqimor (të ftuar special dhe juria) (13 persona x 3 ditë x 2.5 lekë/person)	97.5		97.5			
A.13	Fjetje (të ftuar special dhe juria) (13 persona x 3 netë x 3. lekë/person)	117		117			
A.14	Honorar, Fonist (1 person x 10 lekë/person)	10		10			
A.15	Honorar, Marketing online (1 person x 25 lekë)	25		25			
A.16	Promocion i aktivitetit (ftesa,poster,baner,kancelari)	32.5		32.5			
A.17	Kupë për fituesin e Çmimit Special	5		5			
A.18	Koktejl për natën finale	25		25			
A.19	Dekor për skenën	20		20			
A.20	Shpenzime udhëtimi për personalitetet e ftuara	100		100			
	<b>Shuma</b>	<b>1,309</b>		<b>1,309</b>			
<b>Shpe nizamet për çdo aktivitet 2024</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpenzime për aktivitetin	1,309		1,309			
	<b>Shuma</b>	<b>1,309</b>		<b>1,309</b>			
<b>Shpe nizamet për çdo aktivitet 2025</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpenzime për aktivitetin	1,309		1,309			
	<b>Shuma</b>	<b>1,309</b>		<b>1,309</b>			
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar– Dhjetor 2023 Janar – Dhjetor 2024 Janar – Dhjetor 2025		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>  Stafi i Qendrës Kulturore "Pjetër Gaci" <b>Institucioni Likuidues:</b> Dega Ekonomike e Kultures					

Nr.17	P08220.Q1.O3.A6 "Ahengu Shkodran"	<b>Funksioni 8</b> <b>Argëtim Kultura dhe Feja</b>  <b>N/funksioni 082</b> <b>Shërbime kulturore</b>  <b>Lloji i programit 08220</b> <b>Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.</b>					
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>							
<b>i. Situata</b>							
<p>Pjesë e traditës së këngës popullore shkodrane është dhe "Ahengu Shkodran", i cili me të drejtë është shpallur si një ndër shtatë kryeveprat e trashëgimisë shpirtërore shqiptare.</p> <p>Në ditën e trashëgimisë kulturore, me 29 shtator, organizohet aktiviteti tradicional "Ahengu Shkodran".</p> <p>Prej vitesh tashmë, ai është kthyer në një traditë të përvitshme në qytetin e Shkodrës, duke dhënë një kontribut të çmuar, jo vetëm në organizimin e një aktiviteti popullor shumë të dashur, por edhe duke dhënë kontributin e tij në promovimin e vlerave të veçanta të qytetit tonë dhe të talenteve të reja.</p> <p>Synimi kryesor i këtij aktiviteti është përcjimi i traditës tek brezat e rinj, përmes njohjes së vlerave kulturore autoktone dhe promovimi i tyre në rang kombëtar dhe ndërkombëtar.</p> <p>Aktiviteti ka një ndjeshmëri të lartë artistike për qytetin. Aty janë të përfshirë forcat më të mira krijuese dhe interpretuese të kësaj trashëgimie.</p> <p>"Ahengu Shkodran" çdo vit ka në përbërjen e tij instrumentistë dhe këngëtarë të rinj në moshë, të cilët i kanë sjellë një frymë të re kësaj rryme muzikore.</p> <p>Vihet re që vitet e fundit në ambientet festive familjare të qytetit ka devijime të shijeve muzikore, ndaj ky aktivitet ka një kontribut të rëndësishëm në kultivimin e muzikës qytetare, sidomos për edukimin e brezit të ri.</p> <p>Aktiviteti do të regjistrohet në studio- audio, masteri i të cilit do të përdoret për promovime të ndryshme.</p>							
<b>ii. Synimi i projektit</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vazhdimësia e kësaj tradite, e cila na dallon nga të gjitha trevat e tjera.</li> <li>• Edukimi i brezit të ri me bukurinë e këngës shkodrane.</li> <li>• Ruajtja e trashëgimisë shpirtërore jo materiale.</li> <li>• Promovimi i kostumeve popullore të Shkodrës.</li> <li>• Nxitja e turizmit kulturor.</li> </ul>							
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ngritja e grupit realizues.</li> <li>• Përzgjedhja e repertorit, këngëtarëve dhe instrumentistëve.</li> <li>• Përgatitja dhe realizimi i materialeve promocionale.</li> <li>• Realizimi i dekorit, fonisë, ndriçimit dhe ambjenteve.</li> <li>• Bashkërendimi i punëve për realizimin.</li> </ul>							
<b>b) Rezultatet që prisni</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritje e interesit dhe e cilësisë së interpretimit të këngës qytetare sidomos tek këngëtarët e rinj.</li> <li>• Edukimi i shijeve artistike të artdashësve në masë të gjerë.</li> <li>• Promovimi i figurave të njohura që kanë kontribuar në fushën e këngës qytetare.</li> <li>• Promovimi i kostumeve popullore të Shkodrës.</li> </ul>							
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Komuniteti artistik dhe artdashës. Talentet e reja, instrumentistët; Studiuues dhe bashkëpunëtor të muzikologjisë Grupi i valleve				Bashkia Shkodër. Muzeu Historik "Oso Kuka". Teatri "Migjeni". Të ardhurat nga biletat. Donatorë të mundshëm.			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>							
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Honorare, Këngëtarë, 10 persona x 8,000 lekë	80			80		
A.2	Honorare, Këngëtarë të rinj. 8 persona x 5,000 lekë/ person	40			40		
A.3	Honorare, Orkestrues, 20 orkestrime x 5,000 lekë/ person	100			100		
A.4	Honorare, Instrumentistë, 7 persona x 15,000 lekë/ person	105			105		
A.5	Honorar, Konferencier/skenar 1 person x 20,000 lekë/ person	20			20		
A.6	Honorar Regjizor 1 person x 20,000 lekë	20			20		
A.7	Honorar Fonist 1 person x 100,000 lekë Honorar Teknik Ndriçimit 1 Person x 20,000	120			120		



	lekë						
A.8	Promocion i aktivitetit (ftesa, poster, baner, kancelari)	35			35		
	<b>Shuma</b>	<b>520</b>			<b>520</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2024</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpenzime të aktivitetit	520			520		
	<b>Shuma</b>	<b>520</b>			<b>520</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpenzime të aktivitetit	520			520		
	<b>Shuma</b>	<b>520</b>			<b>520</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar– Dhjetor 2023 Janar – Dhjetor 2024 Janar – Dhjetor 2025		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i Qendrës Kulturore “Pjetër Gaci” <b>Institucioni Likuidues:</b> Dega Ekonomike e Kultures					



Nr.18	P08220.Q1.O3.A7 Honorare "Grupi i valleve"	<b>Funkcioni 8</b> <b>Argëtim Kultura dhe Feja</b>  <b>N/funkcioni 082</b> <b>Shërbime kulturore</b>  <b>Lloji i programit 08220</b> <b>Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e</b>				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>						
<b>i. Situata</b>						
<p>Grupi i valleve ka një traditë në vite me një numër të madh pjesëmarrësish dhe drejtuesish të njohur, të cilët kanë kontribuar në shumë aktivitete të ndryshme, duke na lënë një pasuri të çmuar në këtë fushë. Siç dihet edhe kërcimi dhe vallja kanë shoqëruar popullin tonë në festa të ndryshme me karakter familjar apo ritualistikderi në kohët e sotme.</p> <p>Profesionistë dhe amatorë të kësaj fushe u mbështetën në këtë traditë të pasur dhe arritën të realizonin shfaqje me vlera artistike në bashkëpunim edhe me arte të tjera të zhvilluara në qytetin tonë.</p> <p>Ndër vite janë inskenuar tablo të ndryshme, akte operash, dasma, përfaqësim ansamblesh brendadhe jashtë vendit. Pjesëmarrja e grupit të valleve ka qenë thujse në të gjitha festivalet popullore dhe folklorike ku edhe është nderuar me trofe si grup dhe në elementët veçantë solistik të tij.</p> <p>Vitet e shkuara ky grup mori pjesë në disa shfaqje të karaktereve të ndryshme, të realizuara në territorin e Bashkisë Shkodër si dhe përfaqësoi Shqipërinë në Festivalin e Ansambleve Popullore në Priepolie, Serbi.</p> <p>Bashkia Shkodër e ka financuar rregullisht për 10 muaj të vitit, por edhe duke i siguruar realizimin e aktiviteteve të shumta. Kjo trupë duhet të vazhdojë të financohet edhe në vazhdim me të njëjtat honorare dhe kushte që ka aktualisht. Grupi i valleve i mbështetur nga Bashkia Shkodër do të menaxhohet nga Qendra Kulturore "Pjetër Gaci" që ka në dispozicion koreografin dhe bazën materiale që i duhet trupës.</p> <p>Kjo trupë përbëhet nga 12 persona, 6 vajza dhe 6 djem për 10 muaj të vitit. Ajo do t'i përgjigjet të gjitha aktiviteteve artistike ku kërkohet një trupë e këtij formati.</p> <p>Programi është pjesëmarrja në festa të ndryshme të qytetit tonë, si Festa e Luleve, koncerte të shkurta në sezonin veror, në festën e Ahengut Shkodran, në festimet e javës së Pavarësisë, etj si dhe pjesëmarrja në të gjitha festat folklorike në Shqipëri sipas kalendarit të Ministrisë së Kulturës.</p>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ruajtja e traditës së këtij formacioni.</li> <li>• Realizimi i aktiviteteve me rastin e festave të ndryshme.</li> <li>• Promovimi i vlerave artistike të kësaj trupe.</li> <li>• Nxitja e turizmit kulturor.</li> </ul>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Realizimi i kontratës kolektive me valltarët.</li> <li>• Realizimi i projekteve të ndryshme artistike për trupën dhe konkretizimi i tyre.</li> <li>• Përzgjedhja e repertorit për të gjitha aktivitetet.</li> <li>• Prova intensive me trupën.</li> <li>• Përgatitja e materialeve promocionale.</li> <li>• Promovimi në media i të gjitha aktiviteteve.</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ruhet tradita e këtij formacioni.</li> <li>• Edukimi i brezit të ri me elementët e traditës dhe asaj bashkëkohore.</li> <li>• Spektatorët marrin kënaqësinë e dëshiruar gjatë performancave artistike.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Komuniteti artistik, valltarët, spektatorët e kualifikuar dhe masa e gjerë.				Bashkia Shkodër.		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
A.1	Honorare Grupit të Valleve 12 persona x 10muaj x 6,000 lekë	720	Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
<b>Shuma</b>		720			720	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2024</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
A.1	Honorare Grupit të Valleve 12 persona x 10muaj x 6,000 lekë	720	Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
<b>Shuma</b>		720			720	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
A.1	Honorare Grupit të Valleve 12 persona x 10 muaj x 6,000 lekë	720	Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
<b>Shuma</b>		720			720	



Shuma	720		720	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar– Dhjetor 2023 Janar – Dhjetor 2024 Janar – Dhjetor 2025	<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i Qendrës Kulturore “Pjetër Gaci” <b>Institucioni Likuidues:</b> Dega Ekonomike e Kultures			



<b>Nr. 19</b>	<b>P08220.Q1.O3.A8 Festivali i Këngës Qytetare "Luleborë"</b>	<b>Funksioni 8 Argëtim Kultura dhe Feja</b>  <b>N/funksioni 082 Shërbime kulturore</b>  <b>Lloji i programit 08220 Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.</b>				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>						
<b>i. Situata</b>						
<p>Qyteti i Shkodrës njihet për bukurinë e këngës qytetare dhe përcjelljen e saj ndër breza. Bashkia Shkodër, në kuadër të rikthimit të traditës të krijimit të këngës qytetare me motive shkodrane ka kthyer tashmë në traditë organizimin e përvitshëm të Festivalit të Këngës Qytetare "Luleborë". Ai ka treguar që ka një impakt pozitiv tek qytetarët, duke patur parasysh edhe lidhjen shpirtërore me këtë lloj zhanri muzikor.</p> <p>Nisma për organizimin e këtij Festivali synon ruajtjen e vlerave të muzikës qytetare dhe pasurimin e saj me repertor të ri. Festivali "Luleborë", ka si qëllim t'i japë një dimension të ri këngës qytetare, duke ruajtur vazhdimësinë e një tradite të hershme dhe me shumë vlerë për qytetin e Shkodrës dhe gjithë Shqipërisë.</p> <p>Duke parë forcat krijuese dhe interesimin e madh qytetar për këtë Festival, ai është në vendin që i takon, në Shkodër. Festivali "Luleborë" ka gjithëpërfshirje të krijuesve në muzikë, tekste, orkestrime dhe intepretim. Krijimtaria dhe inteprimi do të vlerësohen nga një juri e përbërë nga personalitete të fushës së artit.</p> <p>Gjatë vitit 2020, për shkak të pandemisë globale, aktiviteti u zhvillua në ambiente të hapura pranë Teatrit Migjeni me pjesëmarrjen e gjerë të këngëtarëve shkodranë. Mikpritja e publikut ishte e mrekullueshme duke e vlerësuar si një iniciativë që përcolli shumë emocione në këtë situatë të rënduar.</p>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ruajtja e këngës qytetare shkodrane dhe pasurimi me këngë të reja.</li> <li>• Edukimi dhe afirmimi i artistëve, kryesisht i brezit të ri, të cilët e duan dhe e promovojnë këngën qytetare shkodrane dhe shqiptare.</li> <li>• Nxitja e turizmit kulturor.</li> </ul>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ngritja e grupit realizues.</li> <li>• Kontakti me krijuesit, përzgjedhja e këngëve, këngëtarëve dhe instrumentistëve.</li> <li>• Prova intensive me orkestrën dhe këngëtarët.</li> <li>• Sigurimi i ambienteve, fonisë, ndriçimit dhe e gjithë bazës materiale.</li> <li>• Përgatitja e materialeve promocionale dhe reklamimi cilësor në media.</li> <li>• Realizimi i dekorit të ambienteve.</li> <li>• Bashkërendimi i punëve me stafin realizues.</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritja e interesit për të gjithë komunitetin artistik dhe artdashës, për ruajtjen dhe pasurimin me repertor të ri të kësaj trashëgimie, e cila na dallon nga kulturat e komuniteteve të tjera.</li> <li>• Rritja e nivelit artistik të krijimit dhe të interpretimit.</li> <li>• Gjallërimi i mëtejshëm i jetës artistike në qytet dhe më gjerë.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshmenëprojekt</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Komuniteti artistik dhe artdashës</li> </ul>				Bashkia Shkodër. Teatri "Migjeni". Të ardhurat nga biletat. Donatorë të mundshëm.		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Honorare, Autori i muzikës, 17 persona x 40,000 lekë	<b>680</b>			680	
A.2	Honorare, Autori i tekstit, 17 persona x 15,000 lekë	<b>255</b>			255	
A.3	Honorare, Orkestrues, 17 persona x 45,000 lekë	<b>765</b>			765	
A.4	Honorare, Këngëtar, 17 persona x 20,000 lekë	<b>340</b>			340	
A.5	Honorare, Instrumentist, 6 persona x 25,000 lekë (harqe) 13 x 30,000 lekë	<b>540</b>			540	
A.6	Honorare, Çmimi i parë, 1 person/grup x 50,000 lekë	<b>50</b>			50	
A.7	Honorare, Çmimi i dytë, 1 person/grup x 35,000 lekë	<b>35</b>			35	

A.8	Honorare, Çmimi i tretë, 1 person/grup x 20,000 lekë	20			20		
A.9	Honorar, Udhëheqës artistik 2 persona x 150,000 lekë	300			300		
A.10	Honorar, Regjizor 1 person x 50,000 lekë	50			50		
A.11	Honorar, Skenari 1 person x 40,000 lekë	40			40		
A.12	Honorare, Juria 5 persona x 20,000 lekë	100			100		
A.13	Honorare, Back vocal, 4 persona x 10,000 lekë	40			40		
A.14	Honorare, Moderator 1 person/grup x 50,000 lekë	50			50		
A.15	Honorare, Skenograf 1 person x 200,000 lekë	200			200		
A.16	Honorare, Fonist 1 person x 200,000 lekë	200			200		
A.17	Honorare, Ndriçues 1 person x 200,000 lekë	200			200		
A.18	Honorare, Dirigjent 3 persona x 50,000 lekë	150			150		
A.19	Honorare, Inxhinier Audio, 2 person x 100,000 lekë	200			200		
A.20	Honorare, Promocion 1 person x 100,000 lekë	100			100		
A.21	Honorare, As/Regjisor, 1 person/grup x 50,000 lekë	50			50		
A.22	Honorare, të Ftuar 1 person/grup x 200,000 lekë	200			200		
	<b>Shuma</b>	<b>4,565</b>			<b>4,565</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2024</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A. 1	Shpenzimet për aktivitetin	4,565			4,565		
	<b>Shuma</b>	<b>4,565</b>			<b>4,565</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>			Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A. 1	Shpenzimet për aktivitetin	4,565			4,565		
	<b>Shuma</b>	<b>4,565</b>			<b>4,565</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2023 Janar – Dhjetor 2024 Janar – Dhjetor 2025			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>  Stafi i Qendrës Kulturore “Pjetër Gaci” <b>Institucioni Likuidues:</b> Dega Ekonomike e Kultures				

<b>Nr.20</b>	<b>P08220.Q1.O3.A9</b> <b>“Koncert- Premierë i Orkestrës Frymore”</b>	<b>Funksioni 8</b> <b>Argëtim Kultura dhe Feja</b>				
		<b>N/funksioni 082</b> <b>Shërbime kulturore</b>				
		<b>Lloji i programit 08220</b> <b>Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.</b>				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>						
<b>i. Situata</b>						
<p>Formacioni i Orkestrës Frymore është një nga vlerat e veçanta artistike unike që ka qyteti ynë. Historia e saj i ka fillimet e saj në vitin 1876.</p> <p>Siç dihet ky formacion është vijues i traditave më të mira të formacioneve që kanë debutuar në qytetin e Shkodrës dhe jo vetëm.</p> <p>E mbështetur nga Bashkia e Shkodrës dhe e menaxhuar nga Qendra Kulturore “Pjetër Gaci”, është një formacion mjaft i konsoliduar.</p> <p>Ky formacion është fitues në shumë takime kombëtare dhe ndërkombëtare të organizuara ndër vite të orkestrave frymore.</p> <p>Pjesëmarrëse në konkurset e realizuara për disa vite me radhë në Sarandë, fituese e Çmimit të parë në GiuliaNova, Itali, e ftuar në vende të ndryshme jashtë Shqipërisë, kjo trupë artistike, është një ndër orkestrat frymore më dinjitoze në rang kombëtar.</p> <p>Çdo vit Orkestra Frymore organizon një koncert premierë që zakonisht përkon me javën e pavarësisë.</p> <p>Në kuadër të kësaj tradite, edhe këtë vit Banda e Shkodrës do të realizojë një koncert premierë me repertor tërësisht të ri, i cili do t'i ofrohet spektatorit në formatin e një spektakli.</p>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ruajtja e traditës dhe realizimi i aktivitetit me rastin e festave kombëtare.</li> <li>• Gjallërimi i jetës artistike të qytetit.</li> <li>• Promovimi i vlerave artistike të kësaj trupe.</li> <li>• Nxitja e turizmit kulturor.</li> </ul>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ngritja e grupit realizues.</li> <li>• Përzgjedhja e repertorit.</li> <li>• Sigurimi i partiturave.</li> <li>• Prova intensive me orkestrën dhe artistët e ftuar.</li> <li>• Sigurimi i fonisë dhe ndriçimit.</li> <li>• Përgatitja e materialeve promociionale dhe reklamimi cilësor në media.</li> <li>• Realizimi i dekorit të ambjenteve.</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ruajtja e traditës të këtij formacioni, i cili njihet në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare.</li> <li>• Argëtimi i spektatorit me muzikë të zgjedhur.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshmenëprojekt</b>			
Komuniteti artistik dhe artdashës.			Bashkia Shkodër. Teatri “Migjeni” Donatorë të mundshëm.			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A. 1	Honorare, Këngëtarë, 3 persona x 10,000 lekë/person	30			30	
A. 2	Honorar, Konferencier/skenar 1 person x 20,000 lekë /person	20			20	
A. 3	Honorare, Aranzhim 4 persona x 25,000 lekë /person	100			100	
A. 4	Honorare, krijimtari e re 4 persona x 25,000 lekë /personi	100			100	
A. 5	Honorar, Regjizor 1 persona x 20,000/person	20			20	
A. 6	Promocion i aktivitetit (ftesa, poster, baner, kancelari)	22			22	
A.7	Honorar Fonist 1 person x 100,000 lekë	100			100	
	<b>Shuma</b>	<b>392</b>			<b>392</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2024</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A. 1	Shpenzimet për aktivitetin	392			392	
	<b>Shuma</b>	<b>392</b>			<b>392</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>			Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A. 1	Shpenzimet për aktivitetin					

		392			392		
	<b>Shuma</b>	<b>392</b>			<b>392</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2023 Janar – Dhjetor 2024 Janar – Dhjetor 2025		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>  Stafi i Qendrës Kulturore “Pjetër Gaci” <b>Institucioni Likuidues:</b> Dega Ekonomike e Kultures					

Nr.21	P08220.Q1.O3.A10 "Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Këngës Qytetare"	<b>Funksioni 8</b> <b>Argëtim Kultura dhe Feja</b>  <b>N/funksioni 082</b> <b>Shërbime kulturore</b>  <b>Lloji i programit 08220</b> <b>Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.</b>				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>						
<b>i. Situata</b>						
<p>"Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Këngës Qytetare" është një ndër aktivitetet kombëtare me të dashura për publikun dhe për ansamblet e këngës qytetare. Ai organizohet nje here ne 2 vite.</p> <p>Baza organizative, kriteret dhe projekti i detajuar vijnë nga Ministria e Kulturës dhe Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike, sipas një kalendari që ata hartojnë.</p> <p>Këto aktivitete shërbejnë për ruajtjen e trashëgimisë kulturore shqiptare dhe përhapjen e saj në arenën mbarëkombëtare.</p> <p>Qendra Kulturore "Pjetër Gaci" ka marrë pjesë rregullisht në aktivitete të tilla ku ka fituar disa çmime duke prezantuar muzikën popullore shkodrane.</p> <p>Çmime të para në këtë aktivitet janë fituar ndër vite por gjithashtu nuk kanë munguar edhe vlerësime të tjera për ansamblin përfaqësues si: formacioni më i mirë, çmime karriere për këngëtarët, çmimi këngëtarja më e mirë e festivalit etj.</p> <p>Pjesëmarrja e qytetit tonë në aktivitete kombëtare, të cilat verësojnë dhe promovojnë traditat tona më të mira, janë kontribut i vazhdueshëm i rritjes së cilësisë artistike dhe përcimin e vlerave më të mira tek brezat e rinj.</p>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
Promovimi i këngës popullore shkodrane në arenën kombëtare e më gjerë. Shkëmbimi i eksperiencave me grupe dhe formacione të ndryshme artistike.						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ngritja e grupit realizues;</li> <li>• Përzgjedhja e repertorit, këngëtarëve dhe instrumentistëve;</li> <li>• Sigurimi i partiturave;</li> <li>• Sigurimi i transportit;</li> <li>• Prova intensive me orkestrën dhe këngëtarët e ftuar;</li> <li>• Bashkërendimi i punëve me grupinrealizues;</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritje e interesit dhe e cilësisë së interpretimit të këngës popullore qytetare.</li> <li>• Në të gjitha përfaqësimet grupi i Shkodrës është vlerësuar me çmimet më të larta.</li> <li>• Promovimi i këngës popullore shkodrane në arenën kombëtare e më gjerë.</li> <li>• Edukimi i shijeve artistike të artdashësve në masë të gjerë,</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Komuniteti artistik, instrumentistët dhe muzikantët, spektatorët ekualifikuar por edhe masa e gjerë				Ministria e Kulturës. Bashkia Shkodër. Donatorët të mundshëm.		
<b>e) Shpenzime të llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2024</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Honorare, Këngëtarë, 12 persona x 10,000 lekë	120			120	
A.2	Honorare, Orkestrime 12 orkestracione x 8,000 leke	96			96	
A.3	Honorare, Instrumentist 8 persona x 8,000 lekë	64			64	
A.4	Transport Shkodër – Elbasan - Shkodër,	40			40	
<b>Shuma</b>		<b>320</b>			<b>320</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		Totali (mijë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Shpenzimet për aktivitetin					
<b>Shuma</b>						
<b>f) Periudha e zbatimit</b>			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>			
Janar – Dhjetor 2024			Stafi i Qendrës Kulturore "Pjetër Gaci" <b>Institucioni Likuidues:</b> Dega Ekonomike e Kultures			

Nr.22	P08220.Q1.O3.A11		Funksioni 8 Argëtim Kultura dhe Feja				
	Festival burimor		N/funksioni 082 Shërbime kulturore				
Lloji i programit 08220 Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore							
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>							
<b>i. Situata</b>							
<p>Pasuria kryesore e kombit tonë është folklori muzikor ose siç quhet muzika burimore. Gjurmë të lashtësisë së muzikës burimore janë provuar që prej shekujve 14–13 p.e.s. Në objekte të ndryshme arkeologjike janë paraqitur të qarta vegla popullore që përdoren nga populli ynë deri në ditët tona.</p> <p>Folklori muzikor shqiptar është jashtëzakonisht i pasur, i cili shprehet në të gjitha format muzikore, nga instrumentalet deri tek ato vokalet. Kjo mënyrë e të shprehurit të muzikës ruajti traditën tonëkombëtare duke e përcjellë atë në shekujderi në ditët tona, si një formë autentike.</p> <p>Është e rëndësishme që këto vlera të ruhen dhe të promovohen nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme.</p> <p>Bashkia Shkodër dhe Qendra Kulturore “Pjetër Gaci” organizojnë këtë festival, i cili sjell në vëmendje origjinën e muzikës burimore, të interpretuar nga artistët zgjedhur.</p> <p>Gjatë viteve që do vijnë mendojmë që këtij festivali t'i shtohet si një vlerë e shtuar përfshirja e gjerë e nxënësve të shkollës së muzikës dhe të rinjve që edukohen pranë shkollës në folklorin e territorit. Këto nxënës në bashkëpunim me artistët e folklorit pasurojnë eksperiencat e tyre për të luajtur këtë zhanër muzikor.</p>							
<b>ii. Synimi i projektit</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ruajtja, përcjellja dhe promovimi i muzikës burimore shqiptare</li> <li>• Promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore</li> <li>• Nxitja e turizmit kulturor</li> </ul>							
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ngritja e grupit realizues;</li> <li>• Përzgjedhja e repertorit, këngëtarëve dhe instrumentistëve;</li> <li>• Përgatitja dhe realizimi i materialeve promocionale;</li> <li>• Realizimi i dekorit, fonisë, ndriçimit dhe ambjentëve;</li> <li>• Bashkërendimi i punëve me stafin realizues.</li> </ul>							
<b>b) Rezultatet që prisni</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxitja e studiuesve të rinj për të hulumtuar më shumë në muzikën burimore;</li> <li>• Mbrojtja e trashëgimisë dhe vlerave etno- folklorike;</li> <li>• Njohja e publikut me vlerat e muzikës burimore;</li> <li>• Edukimi i brezave të rinj me vlerat e hershme të traditave tona.</li> </ul>							
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>				
Komuniteti artistik; Instrumentistët dhe muzikantët; Studiues të folklorit; Publiku.			Bashkia Shkodër Donatorë të mundshëm				
<b>e) Shpenzime të llogaritura</b>							
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Honorare, Këngëtarë, 5 person x 20,000 lekë	100		100			
A.2	Honorar Drejtor Artistik 1 person x 40,000 lekë	40		40			
A.3	Honorar Moderator/skenar 1 person x 20,000 lekë	20		20			
A.4	Honorar Regjizor 1 person x 40,000 lekë	40		40			
<b>Shuma</b>		<b>200</b>		<b>200</b>			
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2024</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpenzime për aktivitetin	200		200			
<b>Shuma</b>		<b>200</b>		<b>200</b>			
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpenzime për aktivitetin	200		200			



	<b>Shuma</b>	<b>200</b>		<b>200</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar- Dhjetor 2023 Janar- Dhjetor 2024 Janar- Dhjetor 2025		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i Qendrës Kulturore "Pjetër Gaci" <b>Institucioni Likuidues:</b> Dega Ekonomike e Kultures				

Nr.23	P08220.Q1.O3.A12 Dita ndërkombëtare e Jazz-it	<b>Funksioni 8</b> <b>Argëtim Kultura dhe Feja</b>  <b>N/funksioni 082</b> <b>Shërbime kulturore</b>  <b>Lloji i programit 08220</b> <b>Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.</b>				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>						
<b>i. Situata</b>						
<p>30 Prilli njihet si dita ndërkombëtare e muzikës Jazz, e cila festohet në shumë vende të botës me qëllim rritjen e vetëdijes mbi vlerat e Jazzit si një mjet shprehës dhe edukativ, një muzikë e cila tregon paqe, unitet dhe një dialog bashkëpunimi të zgjeruar mes njerëzve.</p> <p>Muzika Jazz është një stil muzikor shumë intelektual në mënyrën e ndërtimit të saj. Kjo lloj muzike krijon ndjenja dhe emocione të veçanta tek njeriu. Muzika jazz ka lindur nga një përzierje e traditave të muzikës afrikane dhe europiane, që këtu shfaqet dhe ndërthurja kulturore mes vendeve.</p> <p>Bashkia Shkodër ka mbështetur organizimin e ditës botërore të jazzit. Një aktivitet që i jep ngjyra gëzimi qytetit, duke u përmblytur me një koncert disa orësh në Teatrin "Migjeni".</p> <p>Edhe në vazhdim, Bashkia Shkodër do të mbështesë realizimin e një aktiviteti masiv dedikuar ditës ndërkombëtare të muzikës jazz, përmes vendosjes së infrastrukturës dhe stafit mbështetës për të ftuar që vijnë për të festuar këtë festë në Shkodër.</p>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Promovimi i vlerave që mbart muzika jazz në vetvete;</li> <li>• Bashkëpunimi me artistë të njohur kombëtarë dhe ndërkombëtarë;</li> <li>• Krijimi i një tradite të këtij stili muzikor me vlera muzikore, historike dhe edukative;</li> <li>• Respektimi i një axhende ndërkombëtare;</li> <li>• Promovimi i turizmit kulturor.</li> </ul>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ngritja e grupit realizues;</li> <li>• Bashkëpunim me artistë dhe grupe të ndryshme që performojnë këtë rrymë muzikore;</li> <li>• Përgatitja dhe realizimi i materialeve promocionale;</li> <li>• Realizimi i dekorit, fonisë, ndriçimit dhe ambjenteve;</li> <li>• Bashkërendimi i punëve me stafin realizues për realizimin.</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesëmarrje më të madhe të artistëve ndërkombëtarë në Shkodër,</li> <li>• Gjallërimi i turizmit dhe përcjellja e imazheve kulturore të Bashkisë Shkodër edhe jashtë kufijve,</li> <li>• Bashkëpunim i ndërsjelltë mesartistëve shqiptarë dhe të huaj.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Subjekte të ndryshme që zhvillojnë aktivitete artistiko-kulturore, Muzikantë të shquar ndërkombëtarë, Muzikantë të shquar kombëtarë, Grupet rinore të ardhur nga e gjithë Shqipëria				Bashkia Shkodër Donatorë të mundshëm.		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
<b>Totali</b>						
<b>Shp enzimet për çdo aktivitet 2024</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
A.1 Shpenzime për aktivitetin			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
<b>Totali</b>						
<b>Shp enzimet për çdo aktivitet 2025</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
A.1 Shpenzime për aktivitetin			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
<b>Totali</b>						
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2023 Janar – Dhjetor 2024 Janar – Dhjetor 2025		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>  Stafi i Qendrës Kulturore "Pjetër Gaci" <b>Institucioni Likuidues:</b> Dega Ekonomike e Kultures				

Nr.24	P08220.Q1.O3.A13 "Dita e Luleve" 6 Maj	<b>Funksioni 8</b> <b>Argëtim Kultura dhe Feja</b>  <b>N/funksioni 082</b> <b>Shërbime kulturore</b>  <b>Lloji i programit 08220</b> <b>Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.</b>							
<b>b) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>									
<b>i. Situata</b>									
<p>Festimet që lidhen me lulet, i kanë fillesat herët, rreth viteve '30. Zona e Shkodrës, e njohur për rritjen dhe kultivimin e luleve, i ka dhënë gjithmonë një rëndësi të veçantë këtij procesi. Si një zonë e lidhur shumë me natyrën dhe artin, në Shkodër numërojmë rreth 150 tekste këngësh qytetare, të cilat i janë kushtuar luleve.</p> <p>Në vitin 2006 u rikthye tradita e festimit të ditës së luleve dhe që prej asaj kohe, Bashkia Shkodër e mbështet këtë aktivitet çdo vit.</p> <p>Çdo 6 Maj, Shkodra kthehet në një oborr të madh ngjyrash dhe aromash. Në këtë aktivitet bëhen disa organizime artistike, ku përfshihen një sërë aktorësh, që prej kultivuesve të luleve, shkolla të sistemit 9-vjeçar dhe të mesëm, biznese, artistë të zhanreve të ndryshme, organizata etj.</p> <p>Edhe për vitin 2023 janë menduar disa aktivitete artistiko- kulturore që do të zhvillohen në datën 6 Maj në sheshet kryesore të qytetit, ndër të cilat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- "Panairi i luleve", në të cilin do të ftohen të gjithë kultivuesit e luleve, biznese dhe qytetarë të thjeshtë, ku një hapësirë të veçantë do t'ju lihet luleve që qyteti ynë kultivon;</li> <li>- Organizimi me fëmijët e sistemit parashkollor, 9- vjeçar dhe të mesëm, me të cilët do të organizohen aktivitete të ndryshme;</li> <li>- Konkurse të ndryshme;</li> <li>- "Festivali i luleve";</li> <li>- Koncert i madh festiv.</li> </ul>									
<b>ii. Synimi i projektit</b>									
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ruajtja e traditës,</li> <li>• Nxitja e kultivuesve të luleve, si një traditë e hershme e qytetit tonë,</li> <li>• Promovimi i qytetit përmes shfaqjes së trashëgimisë tonëshpirtërore,</li> <li>• Nxitja e turizmit kulturor.</li> <li>• Argëtimi i qytetarëve</li> </ul>									
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>									
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpallja e ftesës së hapur për pjesëmarrje në konkurim për realizimin e projektit,</li> <li>• Vlerësimi i propozimeve nga ana e Këshillit Artistiko- Kulturor, të Bashkisë Shkodër,</li> <li>• Marrëveshje për organizimin e të gjithë aktivitetit ndërmjet stafit të Bashkisë Shkodër dhe subjektit fitues,</li> <li>• Nxitja për zhvillim të aktivitetit në parametrat e kërkuar në Ftesën e Hapur,</li> <li>• Organizimi i aktivitetit,</li> <li>• Monitorimi dhe raportimi i aktivitetit.</li> </ul>									
<b>a) Rezultatet që prisni</b>									
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Trashëgimi në traditën e rritjes dhe kultivimit të luleve,</li> <li>• Pasurimi i territorit të Bashkisë Shkodër me aktivitete artistiko- kulturore,</li> <li>• Pjesëmarrje e gjerë e qytetarëve,</li> <li>• Aktivizimi kulturor i gjeneratave të reja.</li> <li>• Promovim i territorit</li> <li>• Zhvillim ekonomik</li> </ul>									
<b>b) Aktorët e mundshëm</b>				<b>c) Kontributet e mundshme në projekt</b>					
Stafi i Qendrës Kulturore "Pjetër Gaci" Stafi i Teatrit "Migjeni" Artistë dhe grupe të ndryshme artistike, Fëmijë, nxënës/grupe të organizuara rinore Vullnetarë Biznese Komuniteti				Bashkia Shkodër, ZRAR Shkodër. Donatorë të mundshëm					
<b>e) Shpenzime të llogaritura</b>									
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023</b>				Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
					Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Zhvillim i aktivitetit "Dita e Luleve"			500				500	
<b>Shuma</b>				500				500	

Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Zhvillim i aktivitetit "Dita e Luleve"	<b>500</b>				500	
	<b>Shuma</b>	<b>500</b>				<b>500</b>	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Zhvillim i aktivitetit "Dita e Luleve"	<b>500</b>				500	
	<b>Shuma</b>	<b>500</b>				<b>500</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> 6maj 2023 6maj 2024 6maj 2025		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Kultures Arsimit rinise dhe Sportit <b>Institucioni likuidues:</b> Bashkia Shkoder					

Nr.25	P08220.Q1.O3.A14 "Ndërmendje"	<b>Funksioni 8</b> <b>Argëtim Kultura dhe Feja</b>  <b>N/funksioni 082</b> <b>Shërbime kulturore</b>  <b>Lloji i programit 08220</b> <b>Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.</b>				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>						
<b>i. Situata</b>						
<p>Koncerti i fundvitit, i kthyer tashmë në traditë, është një aktivitet me baza të konsoliduara artistike dhe teknike. Historia e koncertit të fundvitit fillon në vitin 2008, ku një grup artistësh ringritën pas shumë vitesh orkestrën simfonike dhe shfaqën në sallën e Teatrit "Migjeni" koncertin e parëtë titulluar "Ndërmendje" dhe nga ajo kohë në fund të dhjetorit zhvillohet çdo vit kjo premierë.</p> <p>"Ndërmendje" është një koncert i karakterit klasik, në të cilin ekzekutohen pjesë nga autorët më të njohur nga vendi dhe bota. Çdo vit repertori i këtij koncerti pasurohet dhe është gjithmonë i dashur për publikun Shkodran, duke i qëndruar besnik karakterit të tij festiv dhe klasik.</p> <p>Koncerti pasurohet edhe me pjesëmarrjen e artistëve më të shquar vendas dhe të huaj, të ftuar si solistë, apo orkestrantë.</p> <p>"Ndërmendje" është aktivitet, icili përfshin të gjithë artistët e kualifikuar të qytetit të Shkodrës dhe jashtë tij. Ruajtja e kësaj tradite, e bën Bashkinë Shkodër pjesë të modelit më të mirëtë vendeve europiane, të cilat realizojnë çdo vit koncertin e fundvitit.</p> <p>Eksperiencia ka treguar që ky projekt kulmon festimet e fundvitit dhe ka pjesëmarrje të gjerë të spektatorëve. Nga eskperiencia e viteve të tjera mund të thuhet që "Ndërmendje" është një ndër aktivitetet më të rëndësishme të vitit, sepse përfshin një masë të gjerë të institucioneve kulturore dhe pothuajse të gjithë artistët e qytetit tonë dhe jo vetëm.</p>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ruajtja dhe promovimi i vlerave të muzikës së kultivuar nëpërmjet interpretimit profesional;</li> <li>• Aktivizimi iformacioneve klasike;</li> <li>• Pasurimi i repertorit klasik, për artistët dhe artdashësit;</li> <li>• Zhvillimi dhe gjallërimi i jetës artistike, kulturore në qytet, gjatë festave të fundvitit.</li> </ul>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpallja e ftesës së hapur për pjesëmarrje në konkurim për realizimin e projektit,</li> <li>• Vlerësim i propozimeve nga ana e Këshillit Artistiko- Kulturor, të Bashkisë Shkodër,</li> <li>• Marrëveshje për organizimin e të gjithë aktivitetit ndërmjet stafit të Bashkisë Shkodër dhe subjektit fitues,</li> <li>• Nxitja për zhvillim të aktivitetit në parametrat e kërkuar në Ftesën e Hapur,</li> <li>• Organizimi i aktivitetit,</li> <li>• Monitorimi dhe raportimi i aktivitetit.</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktivizimi i orkestrës simfonike,</li> <li>• Rritja e nivelit muzikor dhe bashkëpunimi ndërmjet artistëve,</li> <li>• Kultivimi i muzikës klasike,</li> <li>• Promovimi i turizmit kulturor.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Stafi i Qendrës Kulturore "Pjetër Gaci" Stafi i Teatrit "Migjeni" Artistë dhe grupe të ndryshme artistike				Bashkia Shkodër Donatorë të mundshëm.		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023</b>		Totali (mijëlekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Zhvillimi i aktivitetit "Ndërmendje"	1,100				1,100
<b>Shuma</b>		1,100				1,100
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2024</b>		Totali (mijëlekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Zhvillimi i aktivitetit "Ndërmendje"	1,100				1,100
<b>Shuma</b>		1,100				1,100
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		Totali (mijëlekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Zhvillimi i aktivitetit "Ndërmendje"	1,100				1,100
<b>Shuma</b>		1,100				1,100

<b>f) Periudha e zbatimit</b> Dhjetor 2023 (Java e fundit) Dhjetor 2024 (Java e fundit) Dhjetor 2025 (Java e fundit)	<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>  Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit <b>Institucioniliku idues:</b> Bashkia Shkodër
---	---

Nr.26	P08220.Q1.O3.A15 Aktivitete me rastin e 2 Prillit	<b>Funksioni 8</b> <b>Argëtim Kultura dhe Feja</b>  <b>N/funksioni 082</b> <b>Shërbime kulturore</b>  <b>Lloji i programit 08220</b> <b>Trashëimia kulturore aktivitetet artistike e</b>				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>						
<b>i. Situata</b>						
<p>Ngjarjet e 2 Prillit në Shkodër nisën si një protestë qytetare kundër regjimit më të egër komunist që njohu Europa. Ajo ditë shënjoji për Shkodrën dhe të gjithë Shqipërinë të ardhmen e vendit. Në valën e kësaj demonstratë anti-komuniste, u vranë pabesisht katër të rinj dhe qindra të tjerë u plagosën.</p> <p>Djemtë e Shkodrës, Arben Broci, Bujar Bishanaku, Nazmi Kryeziu dhe Besnik Ceka u bënë dëshmorët e demokracisë për një ëndërr të madhe—"Ta shihnin Shqipërinë si e gjithë Europa".</p> <p>Ajo ngjarje që u njoh më pas kombëtarisht dhe përtej si Masakra e 2 Prillit 1991, edhe sot e kësaj dite mbulohet me një mister të madh. Ngjarjes i janë kushtuar dokumentarë dhe dëshmi rrëqethëse, disa nga të cilat Bashkia Shkodër i ka shfaqur në forma të ndryshme për publikun, me qëllim njohjen e të vërtetave, përmes dëshmimeve të aktorëve të ndryshëm, pjesëmarrës në atë ngjarje.</p> <p>Shkodra dhe shkodranët i kujtojnë çdo vit djemtë e saj, duke kujtuar ende ëndrrën e tyre të parealizuar.</p> <p>Ata janë tashmë pjesë e pashlyeshme e historisë tonë dhe e qëndresës antikomuniste, ndërkohë që rruga për ndërtimin e demokracisë në Shqipëri vazhdon të jetë sfida më e rëndësishme.</p> <p>Bashkia Shkodër në respekt të dëshmorëve të demokracisë dhe të gjithë qytetarëve që ishin pjesë e asaj demonstratë, organizon çdo vit aktivitete në homazh të të rënëve dhe në përkujtim të asaj ngjarjeje, e cila bëri ndryshimin e madh në vendin tonë.</p>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>Përkujtim dhe nderim i dëshmorëve të Demokracisë dhe i pjesëmarrësve në demonstratën e 2 Prillit 1991.</li> </ul>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>Organizimi i ceremonialit zyrtar në memorialin "2 Prilli",</li> <li>Bashkërendimi i punëve mes Drejtorisë së Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit dhe Shoqatës "2 Prilli",</li> <li>Organizimi për pritjen zyrtare,</li> <li>Bashkërendimi i punëve për organizimin e aktiviteteve përkujtimore</li> </ul>						
<b>d) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>Sensibilizimi i të gjithë qytetarëve mbi ngjarjet e 2 Prillit 1991,</li> <li>Nderimi i familjeve të martirëve.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Familjet e dëshmorëve, Qytetarët, Partitë politike, Aktorët e teatrit "Migjeni"				Bashkia Shkodër		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023</b>		Totali (mijë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Vendosja e kurorave me lule të freskëta dhe homazhe tek memoriali i 2-Prillit. (4*5,000	20			20	
A.2	Interpretues Honorar, 2 person x 25,000 lekë	50			50	
A.3	Promocion i aktivitetit (ftesa, poster, baner, kancelari)	50			50	
<b>Shuma</b>		<b>120</b>			<b>120</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2024</b>		Totali (mijë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Organizimi i aktivitetit të 2 Prillit	120			120	
<b>Shuma</b>		<b>120</b>			<b>120</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		Totali (mijë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Organizimi i aktivitetit të 2 Prillit	120			120	
<b>Shuma</b>		<b>120</b>			<b>120</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b>			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>			
Janar – Dhjetor 2023			Drejtorja e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			
Janar – Dhjetor 2024			<b>Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër</b>			
Janar – Dhjetor 2025						

Nr.27	P08220.Q1.O3.A16 Festival Jazz-i	<b>Funksioni 8</b> <b>Argëtim Kultura dhe Feja</b>  <b>N/funksioni 082</b> <b>Shërbime kulturore</b>  <b>Lloji i programit 08220</b> <b>Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.</b>				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>						
<b>i. Situata</b>						
<p>Jazz-i është një rrymë muzikore me një histori më shumë se 100 vjeçare. Në vendin tone ai ka filluar të kultivohet prej vitesh nga të rinjtë amatorë dhe profesionistë.</p> <p>Kohë pas kohe në Shkodër kanë performuar grupe dhe solistë të ndryshëm, të njohur dhe të rinj në karrierë, të cilët kanë lënë shenjë dhe janë mirëpritur nga publiku shkodran.</p> <p>Aktivitete të tilla i shërbejnë kultivimit të shijeve muzikore dhe gjithashtu kontribuojnë në rritjen e nivelit të aktiviteteve artistike që organizohen apo mbështeten nga Bashkia Shkodër.</p> <p>Tradita e organizimit të festivaleve të muzikës jazz nuk është e panjohur, ndaj ne e shohim të vlefshëm ruajtjen e kësaj tradite, duke mbështetur teknikisht dhe financiarisht idenë e një festivali të mirëfilltë me muzikë jazz, icili e kthen qytetin në një skenë të muzikës cilësore dhe në mikpritëse të miqve të artit.</p> <p>Edhe vitin që shkoi u organizua "Shkodra Jazz Festival", projekt që organizohet nga Shoqata Kulturore "Rrok Jakaj" prej vitit 2005 dha një mesazh shumë pozitiv në disa drejtime, përmes emrave më të njohur të Jazz-it shqiptar dhe të huaj, duke bërë jehonë në publik dhe në mediat lokale dhe kombëtare.</p> <p>Mesazhet që përcjell muzika jazz lidhen shumë me realitetet sociale që kalojnë shoqëritë dhe krijojnë një bashkëveprim të ndërsjelltë mes grupesh të ndryshme shoqërore.</p> <p>Edhe në vitin 2021, "Shkodra Jazz Festival", zgjati në një hark kohor 28 ditor, duke e kthyer tashmë në traditë muajin Gusht si muaji i muzikës jazz.</p> <p>Ai u zhvillua në qytetin e Shkodrës me të gjitha produktet artistike që Shoqata Kulturore "Rrok Jakaj" organizon prej vitesh.</p> <p>"Rrok Academy", produkt i licensuar i Shoqatës, konsiston në mbajtjen e masterclass-ëve për të rinj që studiojnë muzikë në disa degë të ndryshme, shkrim muzikor, jazz, klasike, fizarmonikë dhe instrumenta të ndryshme individual. Studentët ndiqen nga emra shumë të njohur të muzikës, shqiptarë dhe të huaj.</p> <p>Organizimi i një Festivali Jazz- inë Shkodër kontribuon në zhvillimin e bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe rrit promovimin e vendit tonenë shumë aspekte, artistike, turistike, ekonomike dhe sociale.</p> <p>Qëllimi jonë është që një festival i përmasave të tilla, të hyjë në paketat turistike, vendase dhe të huaja, duke bërë të mundur promovimin e territorit të Bashkisë Shkodër përmes artit.</p>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkodra të ketë një Festival Jazz, si çdo qytet tjetër i emancipuar në Europë;</li> <li>• Bashkëpunimi me artistë të njohur kombëtarë dhe ndërkombëtarë;</li> <li>• Edukimi i spektatorëve me muzikën Jazz e cila ka më shumë se 100 vite histori;</li> <li>• Të krijohet një traditë e këtij stili muzikor me vlera muzikore, historike dhe edukative;</li> <li>• Promovimi i turizmit kulturor.</li> </ul>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpallja e ftesës së hapur për pjesëmarrje në konkurim për realizimin e projektit,</li> <li>• Vlerësim i propozimeve nga ana e Këshillit Artistiko- Kulturor, të Bashkisë Shkodër,</li> <li>• Marrëveshje për organizimin e të gjithë aktivitetit ndërmjet stafit të Bashkisë Shkodër dhe subjektit fitues,</li> <li>• Nxitja për zhvillim të aktivitetit në parametrat e kërkuar në Ftesën e Hapur,</li> <li>• Organizimi i aktivitetit,</li> <li>• Monitorimi dhe raportimi i aktivitetit..</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesëmarrje e artistëve ndërkombëtarë në Shkodër;</li> <li>• Gjallërimi i turizmit dhe përcjellja e imazheve kulturore të Bashkisë Shkodër edhe jashtë kufijve;</li> <li>• Bashkëpunim i ndërsjelltë mes artistëve shqiptar dhe të huaj.</li> </ul>						
<b>c ) Aktorët e mundshëm</b>				<b>c) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Subjekte të ndryshme që zhvillojnë aktivitete artistiko-kulturore, Muzikantë të shquar ndërkombëtarë, Muzikantë të shquar kombëtarë. Grupet rinore				Bashkia Shkodër Donatorë të mundshëm		
<b>e) Shpenzime të llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023</b>		Totali (mijëlekë)	Nga kjo:			
A.1	Zhvillimi i Festivalit Jazz	3000	Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
<b>Shuma</b>		3000			3000	3000
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2024</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
A.1	Zhvillimi i Festivalit Jazz	3000			3000	



	<b>Shuma</b>	<b>3000</b>				<b>3000</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:					
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale	
A.1	Zhvillimi i Festivalit Jazz	<b>3000</b>				3000		
	<b>Shuma</b>	<b>3000</b>				<b>3000</b>		
	<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2023 Janar – Dhjetor 2024 Janar – Dhjetor 2025	<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit <b>Institucioni likuidues:</b> Bashkia Shkodër						

<b>Nr.28</b>	<b>P08220.Q1.O3.A17 Koncertet e Verës</b>	<b>Funksioni 8 Argëtim Kultura dhe Feja</b>  <b>N/funksioni082 Shërbime kulturore</b>  <b>Lloji i programit 08220 Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.</b>				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>						
<b>i. Situata</b>						
<p>E kthyer tashmë në traditë “Koncertet e Verës” janë mënyra më e mirë për atraksionin e turistëve, argëtimin dhe gjallërimin e jetës në territorin e Bashkisë Shkodër gjatë sezonit veror.</p> <p>Vitin e kaluar koncertet nuk u realizuan dot për shkak të situatës së krijuar nga Pandemia Globale Covid-19 dhe kufizimeve të aktiviteteve artistiko-kulturore nga organet përgjegjëse shëndetësore.</p> <p>Në vitin 2023 janë planifikuar 3 koncerte vere, të cilat do të shpërndahen në pjesë të ndryshme të territorit të Bashkisë Shkodër.</p> <p>Promovimi i turizmit kulturor, gjallërimi dhe argëtimi i publikut gjatë sezonit të verës është njëngasynimet kryesore të këtij aktiviteti.</p> <p>Përgjatë sezonit veror janë programuar 4 koncerte të ndryshme që do të mbahen në harkun kohor Korrik–Gusht.</p>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përfshirja e të rinjve (grupe/solistë),</li> <li>• Gjallërimi i jetës artistike gjatë verës,</li> <li>• Promovimi i trashëgimisë kulturore</li> <li>• Nxitja dhe promovimi i turizmit kulturor</li> </ul>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përzgjedhja e solistëve apo grupeve pjesëmarrëse;</li> <li>• Bashkëpunimi për realizimin e skenë/foni/ndriçim</li> <li>• Përcaktimi i vendeve strategjike ku do të mbahen koncertet</li> <li>• Organizimi i aktivitetit,</li> <li>• Monitorimi dhe raportimi i aktivitetit.</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Promovimi i të rinjve,</li> <li>• Gjallërimi i jetës artistike</li> <li>• Pjesëmarrja masive në koncerte,</li> <li>• Promovimi i turizmit kulturor</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Artistë dhe grupe të ndryshme artistike, Grupe të organizuara rinore				Bashkia Shkodër Donatorë të mundshëm		
<b>e) Shpenzime të llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023</b>		Totali (mijëlekë)	Ngakjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Honorare, Këngëtarë, 12 persona x 10,000 lekë	<b>120</b>			120	
A.2	Honorare, Orkestrime 12 orkestracione x 8,000 leke	<b>96</b>			96	
A.3	Honorar Fonist 1 person x 100,000 lekë	<b>100</b>			100	
A.4	HonorarNdriçues 1 person x 100,000 lekë	<b>100</b>			100	
A.5	Honorar, Regjizor 1 person x 40,000 lekë	<b>40</b>			40	
A.6	Inxhinier Audio 1 person x 100,000 lekë	<b>100</b>			100	
A.7	Promocion i aktivitetit (ftesa, poster, baner, kancelari)	<b>44</b>			44	
	<b>Shuma</b>	<b>600</b>			<b>600</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2024</b>		Totali (mijëlekë)	Ngakjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Zhvillimi i “Koncerteve të verës”	600			600	
	<b>Shuma</b>	<b>600</b>			<b>600</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		Totali(mijëlekë)	Ngakjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Zhvillimi i “Koncerteve të verës”	600			600	

	<b>Shuma</b>	<b>600</b>		<b>600</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2023 Janar – Dhjetor 2024 Janar – Dhjetor 2025		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Teatri “Migjeni”, Qendra Kulturore “Pjetër Gaci”  <b>Institucioni Likuidues:</b> Dega ekonomike e kultures				

<b>Nr.29</b>	<b>P08220.Q1.O3.A18 Karnaulet</b>	<b>Funksioni 8</b> <b>Argëtim Kultura dhe Feja</b>  <b>N/funksioni 082</b> <b>Shërbime kulturore</b>  <b>Lloji i programit 08220</b> <b>Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.</b>
--------------	---------------------------------------	---

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Karnaulet në qytetin e Shkodrës janë festuar që në vitin 1861. Kostume nga më të larmishmit, këngëtarë, qytetarë të tjerë të gjithë me maska, të cilët sfiluan në qendër të qytetit nga pjaca e përgjatë rrugës muzeale “Kolë Idromeno” (sot), karvane butaforike etj. na vijnë si dëshmi të hershme të këtij qyteti me tradita, përmes fotove të ndryshme, të ruajtura me fanatizëm dhe krenari nga institucione apo familje të vjetra shkodrane.

Dita e karnaveleve është një festë ku ndërthuret historia dhe kultura, një festë që përcjell jo vetëm harmoni, por thyen rutinën dhe përditshmërinë e qytetit.

Ato kanë patur tipikën e vet të prezantimit të trashëguar në qytetin tonë, që është shpalosur si një opozitë ndaj problematikave prezente, po edhe atë të karakterit dëfryes e kulturor që ka sjellë humor dhe optimizëm; tregues ky që Shkodra ka bërë përherë jetë kulturore të pasur dhe bashkëkohore perëndimore.

Karnaulet që nga viti 2011 organizohen nga Bashkia Shkodër.

Karnaulet e vitit 2017, u kthyen sipas traditës së Shkodrës, duke sjellë elementët vërtetë të trashëgimisë tonë kulturore. Humori tipik shkodran, me anë të të cilit thumbohet realiteti, bëri që të përcillnin përveç argëtimit, edhe mesazhe të qarta politike, sociale, artistike dhe kulturore.

Element tjetër që karakterizon Karnaulet e Shkodrës, janë edhe butaforitë e ndryshme. Vënia në dukje e dobësive dhe të metave të shoqërisë shqiptare në aspektin social dhe politik, përmes satirës të shfaqur në formën e karikaturës, është një element shumë interesant i cili perceptohet shumë shpejt dhe shumë thjeshtë nga çdo lloj publiku. i gjithë aktiviteti u transmetua live nga të gjitha mediat lokale.

Bashkia Shkodër e mbështet këtë projekt çdo vit, si një vlerë e padiskutueshme e qytetit tonë. Ruajtja e traditës në organizimin e Karnaveleve, si një ndër qytetet e vetme në Shqipëri që ruan ende tipologjinë e tyre kombëtare, është e rëndësishme jo vetëm për qytetin, por edhe më gjerë.

**ii. Synimi i projektit**

- Ruajtja e traditës në festimin e karnaveleve tipike shkodrane.
- Transmetimi në komunitet i mesazheve të ndryshme paqeje, pajtimi, tolerancë, mirëkuptimi dhe asaj që është më e rëndësishme, të drejtësisë.
- Të ndikojnë në përmirësimin dhe gjallërimin e jetës kulturore të qytetit e më gjerë.
- Të bëhen Karnaulet një atraksion për shqiptarët dhe turistët e huaj, që do të duan të vizitojnë Shkodrën në këtë periudhë.
- Synohet futja e Karnaveleve në guidat turistike në mënyrë që të jenë sa më të promovuara.
- Kërkohet që festa e karnaveleve të bëhet përherë e më tepër, festë mbarëqytetare, jo vetëm të prezencës shikuese por dhe të aktivizimit direkt të tyre me paraqitjen karnavaleske, qoftë kjo edhe modeste si dhe festimit të saj në familje, rrugë, lagje apo lokale, etj.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Bashkërendimi i punëve me institucionet e varësisë;
- Komunikimi me shkollat 9 vjeçare dhe të mesme
- Përzgjedhja e aktorëve pjesëmarrës
- Organizimi i aktivitetit,
- Monitorimi dhe raportimi i aktivitetit.

**b) Rezultatet që prisni**

- Përfshirje e shumë aktorëve shoqërorë në këtë aktivitet,
- Promovimi i turizmit kulturor,
- Përmirësimi dhe gjallërimi i jetës social- kulturore në qytetin e Shkodrës.
- Gjithëpërfshirja e komunitetit dhe pjesëmarrje e gjerë e komunitetit në festime.

**c) Aktorët e mundshëm**

Institucionet kulturore të Bashkisë Shkodër  
Shkollat e qytetit  
Artistët (aktorë, poetë, instrumentistë, etj)

**d) Kontributet e mundshme në projekt**

Bashkia Shkodër  
Donatorë të mundshëm  
Institucionet publike (Policia, ZVAP, etj)

**e) Shpenzimet e llogaritura**

Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Honorar– Regjia 1 person* 100,000 lekë	<b>100</b>			100		
A.2	Honorar– Kostumograf e Butaforist. 5 persona * 50,000 lekë	<b>250</b>			250		
A.3	Honorar– Libretist 1 person* 50 000 lekë	<b>50</b>			50		

A.4	Honorar artistë pjesëmarrës 10 persona * 10,000 lekë	100			100		
	<b>Shuma</b>	<b>500</b>			<b>500</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2024</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Honorar– Regjia 1 person* 100,000 lekë	100			100		
A.2	Honorar– Kostumograf e Butaforist. 5 persona * 50,000 lekë	250			250		
A.3	Honorar– Libretist 1 person* 50 000 lekë	50			50		
A.4	Honorar artistë pjesëmarrës 10 persona * 10,000 lekë	100			100		
	<b>Shuma</b>	<b>500</b>			<b>500</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Honorar– Regjia 1 person* 100,000 lekë	100			100		
A.2	Honorar– Kostumografë e Butaforistë. 5 persona * 50,000 lekë	250			250		
A.3	Honorar– Libretist 1 person* 50,000 lekë	50			50		
A.4	Honorar artistë pjesëmarrës 10 persona * 10,000 lekë	100			100		
	<b>Shuma</b>	<b>500</b>			<b>500</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2023 Janar – Dhjetor 2024 Janar – Dhjetor 2025		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtorja e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit  <b>Institucioni Likuidues: Bashkia Shkodër</b>					

Nr.30	P08220.Q1.O3.A19 "Shkodra n'fest"	<b>Funksioni 8</b> <b>Argëtim Kultura dhe Feja</b>  <b>N/funksioni082</b> <b>Shërbime kulturore</b>  <b>Lloji i programit 08220</b> <b>Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.</b>					
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>							
<b>i. Situata</b>							
<p>Gjatë muajit Dhjetor për festat e fundvitit Bashkia Shkodër, ka organizuar një 70estive70nc artistike festive, dëfryese për qytetarët e saj.</p> <p>Në qytet, gjatë Dhjetorit, duke filluar nga data 8 Dhjetor, festa e rinisë dhe në ditët në vijim do të organizohen evente të ndryshme artistiko- kulturore për qytetarët dhe turistët që zgjedhin qytetin 70est për të kaluar festat e fundvitit.</p> <p>Ky 70estive i jep shumë gjallëri qytetit 70est, duke ndryshuar rutinën e ditëve të zakonshme dhe duke ndërë atmosferën festive të muajit të fundit të vitit.</p> <p>Gjatë muajit Dhjetor do të organizohen minikoncerte me karakter argëtues, 70estive70nce të grupeve të ndryshme muzikore, kërcimtarë, animatorë, hapësira argëtimi për fëmijë, duke e kthyer qendrën e qytetit në një vend të vërtetë argëtimi.</p> <p>Të rinjtë e qytetit, po ashtu edhe profesionistët, kanë mundësi të bëhen pjesë e këtij projekti.</p> <p>Eksperienca ka treguar që ky aktivitet i shërben jo vetëm pasurimit të jetës kulturore në fundvit, por edhe nxitjes së bizneseve të jenë pjesë e këtij projekti.</p> <p>Gjithashtu, ky projektixit dhe zhvillon turizmin në territorin e Bashkisë Shkodër.</p> <p>Aktivitetet e fundvitit do të mbahen për gjatë gjithë muajit Dhjetor, muaji i 70festive të fundvitit.</p>							
<b>ii. Synimi i projektit</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillimi dhe gjallërimi i qytetit në muajin e 70estive të fundvitit;</li> <li>• Krijimi i një qendre atraktive për turizmin,</li> <li>• Mundësimi i performancave të artistëve të rinj për publikun,</li> <li>• Pasurimi i jetës artistike dhe kulturore në Bashkinë Shkodër gjatë fundvitit.</li> </ul>							
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizimi i aktivitetit,</li> <li>• Monitorimi dhe raportimi i aktivitetit.</li> </ul>							
<b>b) Rezultatet që prisni</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pasurimi i atmosferës festive të fundvitit,</li> <li>• Nxitja e atraksionit për turistët që vizitojnë vendin tonë,</li> <li>• Promovimi i grupeve të ndryshme artistike,</li> <li>• Inkurajimi i biznesit për t'u afruar me formate të tilla,</li> <li>• Argëtimi i qytetarëve.</li> </ul>							
<b>d) Aktorët e mundshëm</b>			<b>e) Kontributet e mundshme në projekt</b>				
Subjekte të ndryshme që zhvillojnë aktivitete artistiko-kulturore, Artistë dhe grupe të ndryshme artistike, Komuniteti			Bashkia Shkodër Shoqata artistike. Donatorë të mundshëm				
<b>e) Shpenzime të llogaritura</b>							
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Honorar 9 këngëtare* 10 000.	90			90		
A.2	Honorar Fonist 2 persona* 100 000.	200			200		
A.3	. Honorar Ndricues 1 person* 100 000.	100			100		
A.4	Honorar inxhinier audio 1 person* 100 000"	100			100		
A.5	Honorar regjizor 2 persona * 50 000	100			100		
<b>Shuma</b>		<b>590</b>			<b>590</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2024</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Zhvillimi i aktivitetit "Shkodra n'fest"	590			590		
<b>Shuma</b>		<b>590</b>			<b>590</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale

A.1	Zhvillimi i aktivitetit "Shkodra n'fest"	590			590		
	<b>Shuma</b>	<b>590</b>			<b>590</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Shkurt – Mars 2023 Shkurt –		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit  <b>Institucioni Likuidues:</b> Bashkia Shkodër					

Nr.31	P08220.Q1.O3.A20 "Festa e Trashëgimisë Kulturore"	<b>Funksioni 8</b> <b>Argëtim Kultura dhe Feja</b>  <b>N/funksioni 082</b> <b>Shërbime kulturore</b>  <b>Lloji i programit 08220</b> <b>Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.</b>				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>						
<b>I. Situata</b>						
<p>Interesi i popullsisë për të vizituar vende të reja me oferta të pasura natyrore dhe kulturore, e ka shndërruar sot turizmin një ndër sektorët kryesor të zhvillimit ekonomik në botë. Ruajtja, mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore ka qenë gjithmonë një prioritet për Bashkinë e Shkodrës. Vlerat e kësaj trashëgimie janë autentike e universale. Si të tilla ato janë edhe vlera të natyrshme të trashëgimisë Europiane dhe Botërore.</p> <p>Duke parë që resurset e Trashëgimisë Kulturore të qytetit tonë janë të pafundme dhe janë të lidhura me ruajtjen e identitetit dhe pasurisë kombëtare, zgjedhja e një pike turistike për organizimin e një aktiviteti kulturor do të ishte mënyra më e mirë e promovimit të këtyre vlerave.</p> <p>"Festa e Trashëgimisë Kulturore", u zhvillua në datat 29-30-31 Korrik në Kalanë e Shkodrës , Gjuhadol dhe Shirokë, i titulluar nga subjekti fitues "Za Fest".</p> <p>Organizatorët e këtij aktiviteti artistik ishin: Bashkia Shkodër dhe Qendra "Albanian Center of Audio Visual &amp; Cinematography"</p> <p>"Za Fest" ishte një kombinim i muzikës, artit pamor, aktivitetit fizik dhe natyrës së bukur të Thethit si dhe nxitje interesit të popullsisë për të vizituar vende të reja me oferta të pasura natyrore dhe kulturore, duke shndërruar sot turizmin një ndër sektorët kryesorë të zhvillimit ekonomik në botë.</p> <p>Ky aktivitet pati si qëllim promovimin e vlerave natyrore dhe kulturore të Kalasë së Shkodrës, mbi të gjitha diversifikimin e ofertës turistike.</p>						
<b>II. Synimi i projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Promovimi i pikave turistike të qytetit tonë dhe Njësi Administrative</li> <li>• Promovimi i vlerave të trashëgimisë tonë kulturore</li> <li>• Nxitja e institucioneve kulturore për bashkëpunim</li> <li>• Nxitje e zhvillimit ekonomik</li> </ul>						
<b>III. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpallja e ftesës së hapur për pjesëmarrje në konkurim për realizimin e projektit,</li> <li>• Vlerësim i propozimeve nga ana e Këshillit Artistiko- Kulturor, të Bashkisë Shkodër,</li> <li>• Marrëveshje për organizimin e të gjithë aktivitetit ndërmjet stafit të Bashkisë Shkodër dhe subjektit fitues,</li> <li>• Nxitja për zhvillim të aktivitetit në parametrat e kërkuar në Ftesën e Hapur,</li> <li>• Organizimi i aktivitetit,</li> <li>• Monitorimi dhe raportimi i aktivitetit.</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëpunimi i vazhdueshëm me Institucionet dhe Shoqatat Kulturore</li> <li>• Aktivitet i një niveli të lartë artistik</li> <li>• Edukimi i publikut me art cilësor,</li> <li>• Promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore</li> <li>• Nxitja e turizmit kulturor,</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Subjekte të ndryshme që zhvillojnë aktivitete artistiko-kulturore, Artistë dhe grupe të ndryshme artistike, Grupe rinore Spektatorët				Bashkia Shkodër, Donatorë të mundshëm		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	TransfertaKapitale
A.1	Zhvillimi i aktivitetit "Festa e Trashëgimisë"	800				800
<b>Shuma</b>		<b>800</b>				<b>800</b>
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2024</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	TransfertaKapitale
A.1	Zhvillimi i aktivitetit "Festa e Trashëgimisë"	800				800
<b>Shuma</b>		<b>800</b>				<b>800</b>
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	TransfertaKapitale
A.1	Zhvillimi i aktivitetit "Festa e Trashëgimisë"	800				800
<b>Shuma</b>		<b>800</b>				<b>800</b>



<p><b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2023 Janar – Dhjetor 2024 Janar – Dhjetor 2025</p>	<p><b>g) Përgatiti dhendjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit <b>Institucioni likuidues:</b> Bashkia Shkodër</p>
---	--

<b>Nr.32</b>	<b>P08220.Q1.O3.A21</b> <b>“Ditët e Kosovës”</b>	<b>Funksioni 8</b> <b>Argëtim Kultura dhe Feja</b>				
		<b>N/funksioni 082</b> <b>Shërbime kulturore</b>				
		<b>Lloji i programit 08220</b> <b>Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.</b>				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>						
<b>i. Situata</b>						
<p>Bashkia Shkodër dhe komuna të ndryshme në Kosovë përherë kanë patur shkëmbime të ndryshme në evente kulturore dhe artistike ndër vite. Përherë përfaqësues të tyre kanë qenë pjesë dhe anëtare të jurive në konkurse dhe çmime të ndryshme si në arte figurative ashtu dhe në muzikë. Kanë qenë dhe pjesëmarrës aktivë të këtyre eventeve duke u vlerësuar me çmime të ndryshme.</p> <p>Këto shkëmbime kulturore kanë rritur së tepërmi lidhjet ndërmjet vendeve tona duke sjellë një përfitim të ndërsjellë si në promovimin e vlerave të secilës komunë dhe Bashkisë tonë, në njohjen e eksperiencave më të mira të secilit, përqafimin e tyre nga të gjithë pjesëmarrësit në këto evente duke ndikuar në një progres të qëndrueshëm rajonal në fushat e mësipërme.</p> <p>Nga zhvillimet e mësipërme ka dalë e nevojshme që të sigurohet një nivel më i lartë cilësor i këtyre takimeve duke i kulmuar ato në organizimin e një dite të vecantë për promovimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi. Kjo ditë do të mbledhë bashkë të gjithë artistët si nga Bashkia Shkodër dhe komuna të ndryshme në Kosovë në një tubim ku qëllimi kryesor do të jetë fuqizimi i eksperiencave të përbashkëta, paraqitja e eksperiencave më të mira të të dyja palëve, përfitimi i dy palëve nga këto eksperiencë duke ndikuar në progres të përbashkët në fushën e kulturës.</p>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Promovimin e vlerave kulturore në mes Bashkisë Shkodër dhe komunave të ndryshme kosovare.</li> <li>• Pjesëmarrja në një axhendë rajonale kulturore,</li> <li>• Promovimi i qytetit,</li> <li>• Nxitja e turizmit kulturor.</li> <li>• Argëtimi i qytetarëve.</li> </ul>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontaktimi i drejtuesve të artit në komuna të ndryshme të Kosovës;</li> <li>• Koordinimi i punëve për mbarëvajtjen e aktivitetit;</li> <li>• Suporti i nevojshëm.</li> <li>• Zhvillimi i aktivitetit.</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkëmbimi i eksperiencave mes artistëve nga Bashkia Shkodër dhe komunat e ndryshme në Kosovë;</li> <li>• Nxitja për bashkëpunime të ngjashme ndër vite me përfitim të ndërsjellë;</li> <li>• Bashkëveprim rajonal në aktivitete kulturore e më gjerë.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Artistë të ndryshëm nga Bashkia Shkodër dhe komunat e ndryshme në Kosovë; Biznese. Komuniteti.				Bashkia Shkodër, Donatorë të mundshëm		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Zhvillimi i aktivitetit “Ditët e Kosovës”					
	<b>Shuma</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2024</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Zhvillimi i aktivitetit “Ditët e Kosovës”					
	<b>Shuma</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Zhvillimi i aktivitetit “Ditët e Kosovës”					
	<b>Shuma</b>					
<b>f) Periudha e zbatimit</b>		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>				
Janar – Dhjetor 2023		Drejtorja e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit.				
Janar – Dhjetor 2024		<b>Institucioni likuidues:</b> Bashkia Shkodër				
Janar – Dhjetor 2025						

Nr.34	P08220.Q1.O3.A22 Pjesë Teatrorë 1	<b>Funksioni: 8</b> <b>Argëtimi Kultura dhe Feja</b>  <b>N/Funksioni 082</b> <b>Shërbime Kulturore</b>  <b>Lloji i Programit 08220</b> <b>Trashëgimia kulturore aktivitetet kulturore e artistike</b>
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>		
<b>i. Situata</b>		
<p>Teatri "Migjeni" është një institucion që ka një ndikim të madh në zhvillimin dhe nxitjen e jetës kulturore artistike në qytetin e Shkodrës. Duke patur parasysh nivelin e lartë intelektual dhe kulturor si dhe dashamirësinë e publikut Shkodrandaj Teatrit dhe aktiviteve të tij, jemi munduar që nga viti në vit të rrisim në nivelin artistik shfaqjet duke rritur kështu edhe pritshmëritë e publikut.</p> <p>Gjatë viteve janë vendosur në skenë drama të nivelit të lartë të autorëve dhe regjizorëve të shquar shqiptarë dhe të huaj duke treguar vlerat e larta artistike dhe kulturore të transmetuara nëpërmjet Teatrit dhe duke i përcjellë ato edhe në gjithë Shqipërinë e mëtej. Për të vazhduar më tej këtë rrugë të nivelit të shfaqjeve nëpërmjet të tjerëve dhe të dramës në veçanti, Teatri "Migjeni" fton të gjithë Autorët, Regjizorët, të paraqesin pjesët e tyre pranë këtij teatri.</p> <p>Kriteret për përzgjedhjen e veprës më të mirë, do të bazohen në politikat artistike Teatrale të Teatrit Migjeni dhe të Bashkisë Shkodër.</p> <p>Gjatë pesë viteve të fundit, në sajë të financimit të projekteve të Bashkisë Shkodër, trupa e Teatrit ka realizuar 20 premiera teatrore. Kjo trupë, për nivelin e lartë artistik dhe profesional, është vlerësuar me çmime kombëtare dhe ndërkombëtare. Publiku i Shkodrës ndjen dhe është i kënaqur me produktin artistik. Rreth 20 000 spektatorë kanë ndjekur këto shfaqje dhe përherë kanë përshëndetur trupën e dramës për emocionet që kjo trupë përcjell.</p>		
<b>ii. Synimi i projektit</b>		
<p>Shkodra ka afirmuar vlera të patjetërsueshme në art dhe kulturë, me të cilat ajo merr kuptim. Të edukojmë spektatorin, sidomos brezin e ri, nëpërmjet artit duke i afuar ata me teatrin nëpërmjet fjalës së shprehur bukur dhe formave të tjera teatrore.</p> <p>Ky projekt synon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të edukojë spektatorin, sidomos rininë nëpërmjet fjalës dhe aktrimit.</li> <li>• Të argëtojë dhe të afrojë spektatorin e të gjitha moshave me Teatrin, jo vetëm nëpërmjet fjalës së shprehur bukur por edhe formave të tjera teatrore.</li> <li>• Të rrisë numrin e spektatorëve</li> <li>• Të gjenerojë të ardhura që do të përdoren për të vazhduar me aktivitete të tjera</li> </ul> <p>Prandaj mendojmë që këtë vit të realizojmë shfaqje cilësore dhe bashkëkohore, e cila t'iflasë publikut shqiptar me gjuhën e kohës. Bazuar në traditën e herëshme të teatrit "Migjeni", me vënie në skenë të dramës, ne synojmë ringjalljen e kësaj tradite, kujtesën për figurat e mëdha të teatrit tonë, në një dimension të përshtatur në kontekstin aktual.</p> <p>Përshtatja e kësaj veprë të famshme, me elemente të reja dramaturgjike.</p>		
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
<p><b>a) Procedurat e përgatitjes së shfaqjes</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>☐ Përzgjedhja nga Këshilli artistik</li> <li>☐ Redaktimi, përshtatja.</li> <li>☐ Shtrimi i platformës regjizoriale.</li> <li>☐ Përzgjedhja e artistëve pjesëmarrës.</li> <li>☐ Përzgjedhja e skenografit.</li> <li>☐ Përzgjedhja e kostumografit.</li> <li>☐ Efektet speciale (ndriçimi, fonia, etj.).</li> <li>☐ Përcaktimi i figurës artistike nga ana pamore (grimi, parukeria).</li> <li>☐ Puna në tavolinë me tekstin.</li> <li>☐ Paraqitja e punës në tavolinë.</li> <li>☐ Puna në skenë e koordinuar me të gjithë elementët skenik (ndriçim, foni, efekte speciale, grim, parukeri, video, audio, publicitet, banera, postera etj.).</li> <li>☐ Prova gjenerale pëmbjllëse.</li> </ul> <p><b>b) Pagesa e honorareve për regjizorin, muzikantin, skenografin, këngëtarin, balerinin</b></p> <p><b>c) Blerje materiale për realizimin e shfaqjes</b></p> <p><b>d) 4. Shfaqjet realizohen sipas kalendarit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>☐ Shfaqja premierë.</li> <li>☐ Shfaqjet në vazhdim (festivalet dhe turne teatrore brenda dhe jashtë vendit).</li> <li>☐ Futja e shfaqjes në repertor.</li> </ul>		

**Tabelë: Honoraret për person në shfaqjet premierë të Teatrit Migjeni:**

Nr.	Emertimi	Paga aktuale bruto e personelit të brendshëm	Përlogaritja sipas Pagës aktuale	Honorare për person/lekë për orë pune
1	Autori i Veprës	Sipas tregut aktual	-	(total)
2	Regjizor	51,000	51,000/174	293
3	Aktori parë	47,000	47,000/174	270
4	Aktori dytë	30,000	30,000/174	172
5	Figurante	Sipas tregut aktual	30,000/174	172
6	Formulimi muzikor	Sipas tregut aktual	47,000/174	270
7	Drejtues muzike	45,040	45,040/174	259
8	Këngëtar	30,000	30,000/174	172
9	Instrumentist	30,000	30,000/174	172
10	Skenografia	Sipas tregut aktual	50,000/174	287
11	kostumografia	30,000	30,000/174	172
12	Koreograf	Sipas tregut aktual	50,000/174	287
13	Balerin	Sipas tregut aktual	30,000/174	172
14	Produksion video (xhirime, efekte vizuale, Montazh etj.)	Sipas tregut aktual	-	40,000
15	Fonist	30,000	30,000/174	172

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfituesve të synuar)**

- Shfaqje me cilësi
- Numër në rritje të spektatorëve.
- Presim që nga tematika që ofron kjo shfaqje të afrojmë Teatrin një target grupmoshash gjithëpërfshirës.

**c) Aktorët e mundshëm**

- Artistët, aktorët e teatrit
- Stafi mbështetës
- Persona të kontraktuar për sigurimin e një shfaqje sa më cilësore
- Artdashësit

**d) Kontributet e mundshme në projekt**

Bashkia Shkodër

**e) Shpenzimet e llogaritura**

Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	<b>Pjesë Teatrore</b>						
A.1.1	Honorare	1,400			1,400		
A.1.2	Skenografi	100			100		
	<b>Shuma</b>	<b>1,500</b>			<b>1,500</b>		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	<b>Pjesë Teatrore</b>						
A.1.1	Honorare	1,400			1,400		
A.1.2	Skenografi	100			100		
	<b>Shuma</b>	<b>1,500</b>			<b>1,500</b>		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	<b>Pjesë Teatrore</b>						
A.1.1	Honorare	1,400			1,400		
A.1.2	Skenografi	100			100		
	<b>Shuma</b>	<b>1,500</b>			<b>1,500</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b>		<b>Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>					
Janar – Dhjetor 2023		Bashkia Shkodër					
Janar – Dhjetor 2024		<b>Institucioni likuidues: Teatri Migjeni</b>					
Janar – Dhjetor 2025							

